



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS

RAPORTI VJETOR **2010**

DHE

SYNIMET KRYESORE PËR VITIN **2011**

Autoriteti i Konkurrencës

Adresa: Rr. Sami Frashëri, nr. 4,
Kati IV, Tiranë

Tel: +355 4 2 234 504

Fax: +355 4 2 234 497

Faqe e internetit: www.caa.gov.al

Email: competition@caa.gov.al

Tabela e Përmbajtjes

A. Fjala e hyrjes	3
B.Parimet e funksionimit dhe misioni i Autoritetit të Konkurrencës	5
C. Zhvillimet kryesore të aktivitetit	5
D.Struktura organizative, forcimi i kapaciteteve administrative dhe zbatimi i buxheti	8
D.1. Struktura organizative.....	8
D.2 Forcimi i kapaciteteve administrative	10
D.3 Realizimi i buxhetit për vitin 2010.....	10
I. Aspektet e zbatimit të Ligjit dhe Politikës së Konkurrencës	12
I.1 Marrëveshjet e ndaluara	12
I.2 Abuzimi me pozitën dominuese	14
I.3 Kontrolli i Përqëndrimeve	17
I.4 Studimi dhe monitorimi i Tregut	21
II. Avokatia e konkurrencës	26
II.1. Vlerësimi i projekt-akteve juridike të institucioneve të tjera	26
II.2. Rekomandime nga monitorimet dhe hetimet në treg	27
II.3 Reforma rregullatore (RIA).....	29
II.4 Bashkëpunimi me entet rregullatore dhe institucionet e tjera	30
II.5 Ekzekutimi i vendimeve të Komisionit të Konkurrencës	30
III. Ankesat dhe kultura e konkurrencës	32
III.1 Ankesat - instrument i rëndësishëm.....	32
III.2 Rritja e kulturës së konkurrencës.....	37
IV. Integrimi europian në fushën e konkurrencës	39
IV.1 Përmirësimi i kuadrit ligjor.....	40
IV.2 Pyetësi i Komisionit Europian- Politika e Konkurrencës.....	44
IV.3 Asistenca teknike e Komisionit Europian.....	45
IV.4. Bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare.....	46
V. Synimet kryesore të punës për vitin 2011	46
V. 1. Mbikqyrja e tregjeve.....	47
V.2 Liberalizimi dhe të drejtat ekskluzive	47
V.3 Rritja e advokatisë dhe kulturës së konkurrencës	48
V.4 Forcimi i kapaciteteve administrative.....	49
V.5 Konsolidimi i bashkëpunimit institucional dhe marrëdhënieve ndërkombëtare	50
Shtojcë 1-Të dhëna statistikore mbi vendimet e Komisionit të Konkurrencës sipas viteve	51
Shtojcë 2- Vendimet administrative(gjobat) e vendosura nga Komisioni i Konkurrencës	52
Shtojcë 3: Matrica e vlerësimeve dhe rekomandimeve të AK për vitin 2010	53
Shtojcë 4: Raport progresi i KE për Shqipërinë për vitin 2010 (Konkurrenca)	58
Shtojcë 5: Struktura e Autoritetit të Konkurrencës	1

A. Fjala e hyrjes

Ekonomia shqiptare, gjatë periudhës së funksionimit si ekonomi e orientuar drejt tregut, karakterizohet nga dy procese kryesore: privatizimi dhe liberalizimi si dhe përfshirja në ekonominë globale. Këto procese kanë evidentuar rëndësinë e promovimit dhe të mbrojtjes së konkurrencës nëpërmjet instrumentave ligjore dhe institucionalë, si faktorë nxitës i rritjes së përgjithëshme ekonomike.

Instrumenti bazë ligjor përbëhet nga Ligji “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Politika Kombëtare e Konkurrencës, por jo vetëm. Promovimi dhe nxitja e konkurrencës kërkon që të reflektohet si filozofi bazë e gjithë akteve normative që draftohen nga të gjitha entet rregullatore dhe institucionet qendrore dhe vendore, të cilat kanë efekte në funksionimin e tregjeve.

Instrumenti bazë institucional i mbrojtjes së konkurrencës është Autoriteti i Konkurrencës, por jo vetëm. Sistemi që mundëson mirë funksionimin e tregjeve përfshin edhe entet rregullatore të tregjeve që kanë karakteristika specifike, institucionet vendimmarrëse të ekzekutivit qendror dhe atij vendor. Prandaj, bashkëpunimi i ngushtë me të gjitha këto institucione dhe forcimi i instrumentave për të rritur kujdesin ndaj promovimit dhe nxitjes së konkurrencës apo reduktimi i kufizimeve të konkurrencës që rrjedhin nga aktet normative apo praktikrat e këtyre institucioneve, ka qënë një nga drejtimet kryesore të veprimtarisë së institucionit të konkurrencës.

Në tërësinë e vet, filozofia e funksionimit të institucionit të konkurrencës është përmirësimi i vazhdueshëm duke mësuar nga problematikat dhe konsoliduar rritjen e vazhdueshme duke patur si orientim standartet dhe praktikrat më të mira europiane, fakt i cili është vlerësuar edhe cilësuar nga mbikëqyrësit tanë të drejtëpërdrejtë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, Kuvendi i Shqipërisë dhe Komisioni Europian nëpërmjet rezolutës dhe progres-raportit

Ndjekja me kujdes e sinjaleve që transmetohen nga aktorët dhe faktorët e tregut për të identifikuar kufizimet e mundshme të konkurrencës nga praktikrat anti-konkurrese ka mundësuar rritjen e llojshmërisë së tregjeve që kanë qënë objekt monitorimi apo hetimi nga institucioni i konkurrencës. Eksperienca e autoriteteve homologe nënvizon se ankesat e operatorve të ndryshëm të tregjeve duhet të përbëjnë instrumentin kryesor të fillimit të procedurave mbikqyrëse të tregut. Për këtë qëllim, konsolidimi juridik dhe procedural i trajtimit të ankesave, dhe mbi të gjitha rritja e besueshmërisë së institucionit të konkurrencës nëpërmjet trajtimit me përgjegjshmëri dhe profesionalizëm të të gjithë ankesave të adresuara, ka qënë një nga aspektet e përmirësimit të mëtejshëm të punës si dhe një sfidë për të ardhmen.

Konsolidimi në rritje i aktivitetit dhe i profilit publik të Autoritetit të Konkurrencës shprehet jo vetëm në rritjen e numrit të ankesave në përgjithësi, por kryesisht, në depozitimin e ankesave për praktika që janë objekt i ligjit të konkurrencës. Rritja e profesionalizmit dhe e ekspertizës së specialistëve konsiderohet si një domosdoshmëri për t’ju përgjigjur kërkesave në rritje për të mbikëqyrur lojën e operatorve në treg dhe për të mbrojtur funksionimin e tregut nga praktikrat antikonkurrese. Sa më evidente dhe aktive është ndërhyrja e institucionit të mbrojtjes së konkurrencës, aq më e sofistikuar bëhet sjellja anti-konkurrese e operatorëve. Kjo fazë e zhvillimit është patur parasysh

gjatë aplikimit për IPA- 2008, financim i Bashkimit European, i cili është në zbatim aktualisht nëpërmjet asistencës teknike dhe projektit të binjakëzimit. Në mënyrë të veçantë, përmirësimi i kapaciteteve administrative në përdorimin e teknikave investigative dhe i analizave ekonomike përbën një nga faktorët kyç të rritjes së pavarësisë institucionale dhe të konsolidimit në rritje të institucionit shqiptar të konkurrencës.

Në bashkëpunim me asistencën teknike, Komisioni i Konkurrencës ka hartuar draftin e strategjisë së advokacisë së Ligjit dhe të Politikës së Konkurrencës, si dhe strategjinë e liberalizimit të atyre sektorëve të ekonomisë ku janë garantuar të drejta ekskluzive dhe të drejta të veçanta. Këto sektorë të ekonomisë janë identifikuar gjatë funksionimit të rrjetit ndërinstytucional të ndërtuar për përgatitjen e pyetësorit, proces në të cilën Autoriteti i Konkurrencës ishte përgjegjës për Kapitullin 8 “Politika e Konkurrencës”. Rëndësia e rrjetit ndërinstytucional qëndron në faktin se nuk ishte një fenomen i momentit, por është një proces i së ardhmes, pasi raportimet e ardhëshme në Komisionin European do të kenë të njëjtën strukturë dhe përgjegjësi. Në këtë këndvështrim Autoriteti do të ketë një ridimensionim në marrëdhëniet ndërinstytucionale duke rritur forcën ndërhyrëse në rastet e dhënieve të të drejtave ekskluzive dhe speciale që në fazën e draftimit të akteve përkatëse normative.

Në muajt e fundit të vitit 2010 dhe në vazhdim, zyrat përmbarimore janë një partner i ri i institucionit të konkurrencës, pasi arkëtimi i gjobave do të mundësojë rritjen e efektivitetit të vendimeve të Komisionit të Konkurrencës ndaj praktikave anti-konkurrese.

Bashkëpunimi aktiv dhe shkëmbimi i eksperiencave janë karakteristikat e marrëdhënieve të autoritetit me partnerët ndërkombëtarë si OECD-Qendra Rajonale e Konkurrencës, Rrjeti Ndërkombëtar i Konkurrencës (ICN).

B.Parimet e funksionimit dhe misioni i Autoritetit të Konkurrencës

Autoriteti i Konkurrencës funksionon në zbatim të Ligji 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar nga Ligji nr 9499 datë 3.04.2006 dhe Ligji nr 10317 datë 16.9.2010) dhe të Politikës Kombëtare të Konkurrencës. Normat dhe parimet e veprimtarisë së Autoritetit e kanë burimin në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në traditën më të mirë administrative të krijuar ndër vite. Veprimtaria e institucionit shqiptar të konkurrencës udhëhiqet nga parimet e drejtësisë, të barazisë dhe paanshmërisë në zbatimin e detyrave të tij funksionale.

Autoriteti i Konkurrencës e ushtron veprimtarinë e tij si një institucion publik, i pavarur, me mision përdorimin e mjeteve të ligjshme për mbrojtjen dhe nxitjen e konkurrencës së lirë dhe efektive, për një treg sa më funksional dhe me synimin final realizimin e përfitimeve sa më të mëdha të mundshme për konsumatorët.

Realizimi i këtij misioni është mundësuar nëpërmjet veprimit sipas vizionit të Komisionit të Konkurrencës, i cili konsiston në vlerësimin objektiv të sjelljes së operatorëve në treg dhe të efekteve të akteve normative të hartuara nga institucionet qendrore dhe rregullatore në funksionimin e tregut. Gjithashtu, vizioni i ndjekur mbështetet në të drejtën europiane të konkurrencës, si dhe në praktikat më të mira të autoriteteve homologe të vendeve të tjera me të cilat vazhdimisht bashkëpunohet dhe shkëmbehen eksperiencat. Por, vecanërisht, veprimtaria për zbatimin e misionit merr parasysh specifikat e ekonomisë shqiptare të tilla si: madhësia e tregut, masa e informalitetit, niveli i kulturës ndaj konkurrencës, etj.

Ky vizion edhe gjatë vitit 2010 është konkretizuar me përcaktimin e objektivave të cilat janë realizuar nëpërmjet një diskutimi gjithëpërfshirës të strukturës së Autoritetit të Konkurrencës. Këto objektiva janë: konsolidimi i kualifikimit të personelit me njohuri më të thella në fushën e ekonomisë dhe të së drejtës, që të jetë i aftë të aplikojë metodologjitë dhe praktikat më të mira për studimin dhe investigimet e tregjeve në zbatim të ligjit; rritjen e advokacisë nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë dhe interaktiv me entet rregullatore e institucionet qendrore; sigurimi i nje transparence të plotë në procedurat e ndjekura të vendimmarrjes dhe të zbatimit të detyrave të tij funksionale; si dhe duke ndjekur me profesionalizëm procedurat me autoritetet gjyqësore dhe përmbartimore.

C. Zhvillimet kryesore të aktivitetit

Autoriteti i Konkurrencës, për realizimin e aktivitetit për vitin 2010, në zbatim të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ka marrë në konsideratë rekomandimet e Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, e Raportit të Progresit të Komisionit Evropian dhe e ka zhvilluar të gjithë veprimtarinë e tij për përmbushjen e misionit, mbrojtjen dhe nxitjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në tregun shqiptar.

Raporti i Progresit i Komisionit Evropian nënvizon se **kuadri ligjor** shqiptar në fushën e konkurrencës është gjerësisht i bazuar në rregullat e BE-së dhe strukturat e nevojshme dhe administrative janë krijuar. Rishikimi i ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” solli një përafrim edhe më të plotë të legjislacionit të konkurrencës me *acqui-communitaire* ndërkohe që po punohet intensivisht dhe me ekspertët e financiar nga BE për plotësimin e kuadrit nënligjor. Në mënyrë më specifike mund të përmendim përfshirjen e nenit 106 të Traktatit të Lisbonës, pra të drejtën e kontrollit mbi të drejtat ekskluzive dhe ato speciale; përjashtimet në bllok të marrëveshjeve që kryesisht synojnë nxitjen e investimeve në teknologji të reja, specializimet dhe kërkim – zhvillimin; nxitjen e zhvillimit të biznesit të vogël nëpërmjet përjashtimit të marrëveshjeve midis ndërmarrjeve që zënë të gjitha së bashku deri në 10-15% të tregut; nxitjen e konsolidimit të instrumentit të ankesës nga operatorët e tregut si instrument bazë i mbrojtjes së konkurrencës efektive në treg; rritjen e forcës kontrolluese dhe parandaluese të institucionit të konkurrencës ndaj ndryshimeve në strukturat e tregjeve të rrjedhura nga transaksionet e shit-blerjeve të aksioneve.

Sikurse është argumentuar në raportimin e vitit të kaluar, viti 2010 është konsideruar si viti i **advokacisë** me synimin e nxitjes së konkurrencës. Këtë objektiv Komisioni i Konkurrencës e ka realizuar nëpërmjet një roli proaktiv në tryezat konsultative të organizuara me entet rregullatore dhe institucione të tjera publike dhe të qeverisjes qëndrore. Në këto tryeza konsultative janë diskutuar rekomandimet e rrjedhura nga procesi i monitorimeve apo hetimeve e realizuara nga sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës në tregjet përkatëse. Për të realizuar këtë objektiv është hartuar edhe një strategji e forcimit të advokacisë së konkurrencës, në bashkëpunim me ekspertët e asistencës teknike, sipas të cilës do të propozohen institucioneve legjislative instrumenta të përshkallëzuara me synimin e rritjes së forcës detyruese të rekomandimeve të komisionit të konkurrencës

Në zbatim të ligjit, për të mbrojtur konkurrencën nga praktikat antikonkurrese të operatorve në treg apo nga efektet kufizuese të akteve normative, nëse ato vërehen, janë ndërmarrë **studime, monitorime dhe hetime** të tregjeve mbi bazën e ankesave apo të shenjave të kufizimeve të mundshme të konkurrencës. Gjatë vitit të kaluar janë përfunduar studimet, monitorimet dhe hetimet të filluar në vitin e 2009 respektivisht në: tregun farmaceutik; tregun e profesioneve të lira; tregun e bonove të thesarit; tregun e shërbimeve bankare; tregun e prodhimit në vend të lëndës djegëse gazoil; tregun e prokurimeve të makinave të reja. Gjithashtu, gjatë vitit 2010 janë realizuar monitorimet dhe hetimet në tregje të tjera si: tregu i shpërndarjes dhe i shitjes me pakicë e energjisë elektrike; tregu i ngarkim-shkarkimit dhe i depozitimit të gazit në rrugë bregdetare; tregu i tregu i internetit, tregu i importit dhe i shitjes me shumicë të produkteve ushqimore bazë: sheqer, oriz dhe vaj vegjetal.

Numri i ankesave të depozituara vitin e kaluar pranë autoritetit ka ardhur duke u rritur. Gjatë 2010-tës janë depozituar 11 ankesa, megjithatë vetëm 6 prej tyre prezantonin kufizime të pretenduara të konkurrencës në këndvështrimin e Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Bazuar në ankesat e depozituara janë vëzhguar tregje si: importuesit e gazit; komunikimet elektronike; përpunimin e qumështit; i ruajtjes dhe i sigurisë fizike; i supermarketeve (për produkte specifike); transmetimet digjitale; dhe tregu i sigurimeve. Pra, thelbësore është se tashëm kemi ankesa të operatorve ndaj operatorve të tjerë që operojnë në të njëjtin treg apo në tregje të ndërvarura. Gjithashtu, institucioni i

konkurrencës i ka trajtuar me të njëjtën përgjegjshmëri edhe ankesat e tjera të depozituara duke ia adresuar institucioneve relevante sipas kompetencave.

Në përgjigje të kërkesës së rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë dhe të kësaj situatë të re, Autoriteti i Konkurrencës ka performuar duke ulur **afatet e realizimit** të procedurave të hetimeve, fakt i cili është shprehur edhe në amendimet e reja të ligjit bazë, duke reflektuar në këtë mënyrë rritjen e kapaciteteve administrative si dhe rritjen e përgjegjshmerisë ndaj detyrimit të taksapaguesëve.

Veprimtaria e Autoritetit të Konkurrencës gjatë vitit 2010 pasqyrohet nëpërmjet 34 vendimeve të Komisionit të Konkurrencës, të cilat shprehin aktivitetin shumëdimensional të institucionit të konkurrencës në zbatim të ligjit. Konkretisht, sikurse shprehet në shtojcën 1 “Të dhëna statistikore mbi vendimet e Komisionit të Konkurrencës sipas viteve”, janë marrë 6 vendime që përmbajnë rekomandimet për institucionet qendrore si Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës, Banka e Shqipërisë, Ministria e Inovacionit dhe e Teknologjisë së Informacionit dhe Agjensia e Prokurimeve Publike, si dhe enteve rregullatore si Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Enti Rregullator i Energjisë dhe Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare. 3 vendime që përmbajnë penalitete dhe angazhime ndajë shoqërive që janë argumentuar në shkelje të ligjit për marrëveshje të ndaluar dhe abuzime me pozitën dominuese. 7 vendime që përmbajnë autorizimin e përqëndrimeve apo shitjes dhe blerjes së aksioneve, si dhe 7 vendime për përmirësimin dhe përshtatjen e legjislacionit sekondar në përputhje me amendimet e ligjit bazë të konkurrencës dhe të së drejtës europiane. 11 vendimet e tjera pasqyrojnë tërësinë e procedurave të ndjekura nga Autoriteti i Konkurrencës të cilat bazohen në parimin e transparencës dhe të barazisë.

Një risi tjetër i vitit 2010, lidhet me fillimin e procedurave për **mbledhjen e gjobave** të vendosura nga Komisioni i Konkurrencës. Me hyrjen në fuqi të ndryshimeve në ligjin “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, gjobat e vendosura nga Komisioni i Konkurrencës janë titull ekzekutiv dhe sipas Kodit të Procedurës Civile organi i ngarkuar për mbledhjen e tyre është shërbimi përmbarrimor. Deri më tani janë të paktën 6 raste për të cilat ka dalë vendimi i Gjykatës për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit dhe janë dërguar pranë Zyrës së Përmbarrimit, e cila ka filluar ndjekjen e procedurës.

Autoriteti i Konkurrencës ishte institucioni përgjegjës për përgatitjen e Kapitullit 8 “Politika e Konkurrencës” së pyetësorit të Bashkimit Evropian. Gjatë realizimit të kësaj detyre u mundësua një vështrim i detajuar i kuadrit ligjor dhe praktikave ekzistues të së drejtës shqiptare të konkurrencës. Kjo analizë ndihmoi në identifikimin e mospërputhjeve me të drejtën evropiane të konkurrencës, të cilat u morën parasysh gjatë propozimit të amendimeve të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Një aspekt tjetër shumë i rëndësishëm lidhet me ndërtimin e network-ut ndërinstitutional, i cili mundësoi evidentimin e shkallës së liberalizimit në sektorët e ekonomisë dhe në vecanti të drejtat ekskluzive dhe speciale. Ky network përbën një instrument shumë efikas për forcimin e advokacisë së konkurrencës.

Rritja e **kapaciteteve administrative** për zbatimin me efikasitet të ligjit dhe politikës kombëtare të konkurrencës nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme ka qenë një tjetër arritje e Autoritetit të Konkurrencës gjatë vitit 2010. Me mbështetjen financiare të OECD-së –Zyra rajonale dhe fondeve të buxhetit të shtetit janë trajnuar anëtarët e stafit teknik për çështjet e konkurrencës në seminare të organizuara nga Bashkimi Evropian,

OECD, ICN etj. Gjithashtu, aktualisht nëpërmjet fondëve të IPA-2008 Autoriteti ka asistencë teknike dhe është në zbatim projekti i binjakëzimit.

Kjo veprimtari e Autoritetit të Konkurrencës është vlerësuar nga Komisioni European dhe është shprehur nëpërmjet Raportit të Progresit, i cili konfirmon zhvillimet në fushën e përafrimit të legjislacionit dhe në fushën e zbatimit të Ligjit dhe Politikës së Konkurrencës. Gjithashtu, institucioni i konkurrencës është mbështetur në mënyrë të vazhdueshme nga Kuvendi i Shqipërisë, e shprehur qartësisht në rezolutat mbi aktivitetin, në të cilat janë pasqyruar rezultatet pozitive dhe detyrat për të ardhmen.

D.Struktura organizative, forcimi i kapaciteteve administrative dhe zbatimi i buxheti

Autoriteti i Konkurrencës gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij si një institucion publik, i pavarur me mision mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, ka konsideruar si faktor shumë të rëndësishëm për pavarësinë e funksionimit rritjen e shkallës së ekspertizës së këtij stafi duke konsideruar trajnimin e tyre si investim.

Struktura e Autoritetit të Konkurrencës ka mbetur e pandryshuar gjatë vitit 2010 dhe paraqitet sipas Vendimit të Kuvendit të Shqipërisë Nr.182 datë 12.05.2008, ndërsa numëri i punonjësve është 32 punonjës, nga të cilët 20 persona janë staf teknik i përbërë nga ekonomistë dhe juristë (11 ekonomistë dhe 9 juristë)

D.1. Struktura organizative

Autoriteti i Konkurrencës përbëhet nga Komisioni i Konkurrencës, si organ vendimmarrës, dhe Sekretariati si organ administrativ dhe hetimor. Në shtojcën Nr.5 është vendosur organigrama e Autoritetit të Konkurrencës.

- **Komisioni i Konkurrencës**

Komisioni i Konkurrencës si organ kolegjal ka ushtruar funksionin e tij vendimmarrës në praktikën e hetuara mbi kufizimet e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg. Gjatë vitit 2010, Komisioni i Konkurrencës ka shënuar progres të dukshëm si në drejtim të performancës së vendimmarrjes për zbatimin e ligjit në rastet antitrust duke nxitur diskutimet brenda Komisionit dhe mendimin alternativ ashtu dhe në rritjen e transparencës nëpërmjet organizimit të seancave dëgjimore me palët dhe seancat konsultative me institucionet qendrore dhe entet rregullatorë. Komisioni i Konkurrencës vazhdon të ushtrojë funksionet e tij ligjore me pjesëmarrjen e katër komisionerëve (një nga të cilët kryetari).

- **Sekretariati**

Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, është organi administrativ i ngarkuar me ligj për të kryer monitorimin dhe hetimin për të siguruar konkurrencën e lirë dhe efektive në treg. Sekretariati përbëhet nga tre drejtori dhe sektori i analizës. Sekretariati monitoron kushtet e tregut, kryen hetime administrative dhe harton raporte mbi hetimet, të cilat pranë Komisionit të Konkurrencës për vendimmarrje. Gjatë vitit 2010 Sekretariati ka rritur ndjeshëm numrin e rasteve të monitorimit dhe hetimit në sektorë dhe tregje të

ndryshme për të ndaluar praktikat antikonkurrese dhe për të siguruar konkurrencën e lirë dhe efektive në treg.

Drejtoria Mbikëqyrjes së Tregut

Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut realizon procesin e mbikëqyrjes së sjelljes së ndërmarrjeve në treg në zbatim të ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” dhe Politikës Kombëtare të Konkurrencës. Kjo drejtori përbëhet nga tre sektorë të emërtuar sipas tre shtyllave kryesore që prezantohen në ligj, pra sektori i abuzimit me pozitën dominuese, sektori anti-kartel dhe sektori i përqëndrimeve. Me ndryshimet në strukturën e emërimit të nënpunësve të kësaj drejtorie specialistët dhe përgjegjësit e sektorëve tashmë klasifikohen si “inspektorë” çka ka rritur rolin e tyre investigues në treg dhe ka çuar në një shkrim më të mirë mes përgjegjësive dhe ndarjes së punës brenda Drejtorisë dhe në grupet e punës që ngrihen brenda Autoritetit të Konkurrencës.

Drejtoria Juridike dhe Procedurave

Drejtoria Juridike dhe Procedurave realizon argumentimin juridik të produkteve të veprimtarisë së Sekretariatit, drafton aktet rregullatore në zbatim të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe përfaqëson Autoritetin në proceset gjyqësore në mbrojtje të vendimeve të Komisionit ndaj akt-padive nga palët e prekura. Kjo drejtori është e organizuar në dy sektorë: Sektori i Përafrimit të Legjislacionit dhe Procedurave dhe Sektori i Çështjeve Juridike dhe Hetimit. Puna kryesore e kësaj Drejtorie gjatë vitit 2010 ka qenë hartimi i amendimeve të ligjit dhe plotësimi i pyetësorit, procese këto të realizuara në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Mbikëqyrjes së Tregut.

Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme

Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme është struktura mbështetëse e funksionimit të Autoritetit të Konkurrencës në realizimin e misionit të tij për ruajtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg. Kjo drejtori realizon menaxhimin e burimeve njerëzore në përputhje me kërkesat dhe procedurat e ligjit nr 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i Nëpunësit Civil”, programon zhvillimin e kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve duke shfrytëzuar të gjitha burimet e mundshme si OECD, ICN, RCC, ITAP, Universiteti i Tiranës etj. Një drejtim tjetër i punës së kësaj drejtorie është mbulimi i veprimtarisë financiare të Autoritetit dhe mbajtja e përgjegjësisë së plotë për të gjitha procedurat e hartimit dhe të administrimit të fondeve të buxhetit, në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e buxhetit të Shtetit Shqiptar.

Sektori i studimit dhe analizës

Në bazë të vendimit Nr. 96, datë 30.04.2007 për miratimin e strukturës dhe organikës së Autoritetit të Konkurrencës, ky sektor ka si mision vëzhgimin e kushteve dhe kryerjen e analizave ekonomike të strukturave të ndryshme të tregut. Pavarësisht nga vendosja e punonjësve në sektorë apo drejtori specifike veçoria e punës në Autoritetin e Konkurrencës është puna në grup. Pra, në çdo rast hetimi grupet e punës përmbajnë punonjës që i përkasin sektorëve apo drejtorive të ndryshme. Në kuadër të strategjisë

për advokacinë në konkurrencë, Sektori i Analizës dhe Studimeve është bërë pjesë e këtij projekti dhe gjatë fundit të vitit 2010 ka realizuar kërkime dhe analiza të metodologjive të përdorura nga Komisioni Evropian, OECD, ICN apo Institucionet specifike si OFT mbi Studimin e Tregut. Në funksion të këtij qëllimi, është përgatitur një material mbi praktikën më të mira për Studimet e Tregut i cili do të prezantohet gjatë zbatimit të projektit në vitin 2011.

D.2 Forcimi i kapaciteteve administrative

Gjatë vitit 2010 është rritur ndjeshëm numri mesatar i ditëve të pjesëmarrjes në trajnime për stafin e Autoritetit të Konkurrencës. Trajnimet e detyrueshme të organizuara nga ITAP janë ndjekur nga të gjithë nëpunësit civilë të Sekretariatit të Autoritetit të Konkurrencës. Në 2 trajnime të organizuara nga TAIEK (Njësia e Asistencës Teknike e Komisionit Evropian) në Tiranë në fushën e konkurrencës (i)workshop mbi analiza statistikore dhe econometrike (ii) workshop mbi marrëveshjet e ndaluara dhe lehtësimin nga gjocat) kanë marrë pjesë të gjithë nëpunësit e Autoritetit të Konkurrencës.

Një mundësi e shfrytëzuar maksimalisht nga stafi i Autoritetit të Konkurrencës janë workshop-et e organizuara nga qendra rajonale për konkurrencën e OECD-së në Hungari ku kanë marrë pjesë më shumë se 90 për qind e stafit të Sekretariatit.

Gjithashtu nëpunësit e Autoritetit të Konkurrencës janë trajnuar nga ekspertët e projektit të Asistencës Teknike të financuara nga Komisioni Evropian, nga ekspertët nga GTZ, Rrjeti Ndërkombëtar i Konkurrencës etj..Trajnime janë marrë edhe në fusha të tjera që kanë lidhje me çështjet e konkurrencës si përafrimi I legjislacionit me atë të Bashkimit Evropian në fushën e tregtisë, të drejtën e autorit etj.

D.3 Realizimi i buxhetit për vitin 2010

Autoriteti i Konkurrencës në zbatim të ligjit nr. 101190, datë 4.12.2009 “Për buxhetin 2010” ka manaxhuar 62, 360 mijë lekë të buxhetuar, të cilat janë realizuar në fakt në një përqindje mesatare 92.2%.

Mosrealizimi ka ardhur kryesisht në zërin “paga dhe sigurime shoqërore” në masën 4 milionë e 114 mijë lekë për shkak të mosplotësimit të tre vendeve vakantë (një antar i Komisionit dhe 2 inspektorë). Për vendin e paplotësuar të antarit të komisionit është njoftuar Kuvendi. Ndërsa për vendët e paplotësuar të inspektorëve janë realizuar procedurat e miratimit të strukturës në Kuvend, procedura të cilat pësoan shtyrje pas VKM nr. 591, datë 23.7.2010 “Për disiplinimin e fondeve buxhetore”, me të cilin u pezulluan ndryshimet strukturore me efekte financiare. Po ashtu në këtë zë përfshihet dhe fondi i pagave për muajin dhjetor 2010 që u spostua në muajin janar 2011.

Përsa i përket zërave “materiale dhe shërbime të përgjithshme” si dhe “investime”, janë realizuar respektivisht 96 % dhe 92.5 %. Mosrealizimi në shifra të ulta rreth 730 mijë leke vjen si rezultat i mbetjeve nga procedurat e prokurimeve.

Gjatë vitit 2010 Autoriteti i Konkurrencës ka realizuar të ardhura në buxhetin e shtetit rreth 2 341 000 lekë nga të cilat 2 135 000 lekë janë të ardhura nga procedurat e kontrollit të përqëndrimeve dhe pjesa tjetër 206 000 lekë të ardhura nga shitja e një automjeti me procedurë ankandi.

I. Aspektet e zbatimit të Ligjit dhe Politikës së Konkurrencës

Ligji për mbrojtjen e konkurrencës përbëhet nga tre shtylla kryesore të mbrojtjes së lojës së lirë të operatorve në treg nga praktikant antikonkurrese: marveshjet e ndaluara; abuzimi me pozitën dominuese dhe kontrolli i përqëndrimeve, të cilat përbëjnë edhe aspektet kryesore të aktivitetit të Autoritetit të Konkurrencës.

I.1 Marrëveshjet e ndaluara

Marrëveshjet, të cilat kanë si objekt ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, veçanërisht marrëveshjet që: caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi; kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet; ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit; janë gjithmonë të ndaluara. Fiksimi i çmimeve dhe kufizimi i prodhimit bëjnë që klientët të paguajnë çmime më të larta ose mos marrjen e sasive të dëshiruara. Marrëveshjet e ndaluara dëmtojnë mirëqenien sociale, krijojnë ineficencë dhe kalojnë mirëqenien nga konsumatorët tek pjesëmarrësit në marrëveshje.

Autoriteti i Konkurrencës ka realizuar monitorime, dhe hetime, me synimin e zbulimit të marrëveshjeve apo të praktikave të koordinuara midis operatorëve në disa tregje, të cilat janë në vijim:

- **Hetimi i Thelluar në Tregun e Prokurimeve të Automjeteve të Reja**

Sikurse është paraqitur edhe në raportin e vitit 2009, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr 135 datë 21.12.2009 vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimeve të automjeteve të reja, me objekt ekzistencën ose jo të marrëveshjeve në oferta që kufizojnë konkurrencën në tregun përkatës. Në vijim, Sekretariati realizoi procedurat hetimore në përputhje me Ligjin dhe Kodin e Procedurave Administrative dhe në përfundim të tyre paraqiti pranë Komisionit të Konkurrencës raportin e hetimit të thelluar. Në raportin e hetimit të thelluar pretendohet se nga analiza e sjelljes së këtyre ndërmarrjeve në treg, vërtetohet ekzistenca e marrëveshjes në oferta ndërmjet tyre, e cila në kuptim të Ligjit Nr. 9121 datë 28. 07. 2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 4, pika 1, gërma a), konsiderohet marrëveshje e ndaluar, pasi ka për objekt dhe pasojë kufizimin në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në tregun e prokurimit të automjeteve të reja.

Gjatë analizës së konkurrencës (bazuar edhe në metodologjinë e OECD-së “Për luftën ndaj koordinimit të ofertave në prokurimet publike”) u vu re se ndërmarrjet objekt hetimi përdorin skemën e nënkontraktimit (furnizimit), skemën e ofertës së mbuluar duke rënë dakord me përpara se cili do paraqesë ofertën fituese, skemën e ofertës në rotacion, duke paraqitur në rrotullim ofertën me të ulet që të jenë fitues.

Në zbatim të nenit 39 të Ligjit Komisioni i Konkurrencës organizoi seancat dëgjimore me ndërmarrjet objekt hetimi: “Classic” sh.p.k; “Ultra motors” sh.p.k; “Noti” sh.p.k; dhe “Hyundai Auto Albania” sh.p.k., të cilat paraqitën pretendimet e tyre mbi raportin e hetimit të thelluar në seancat dëgjimore, si dhe me shkrim, pretendime që janë marrë në konsideratë nga Komisioni i Konkurrencës.

Në vijim të procedurave, Komisioni i Konkurrencës me shumicë votash vendosi nëpërmjet Vendimit Nr. 154, datë 01.10.2010 ndalimin e marrëveshjes në oferta në tregun e prokurimeve të automjeteve të reja midis ndërmarrjeve "Classic" sh.p.k; "Ultra motors" sh.p.k; "Noti" sh.p.k; dhe "Hyundai Auto Albania" sh.p.k, si marrëveshje e ndaluar në kuptim të nenin 4 të ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", Gjithashtu, vendosi penalizimin e tyre për shkeljen e ligjit, bazuar në rregulloren e llogaritjes së gjobës, respektivisht për shumat: 25,712,000 lekë; 1,517,000 lekë; 2,994,000 lekë; dhe 5,383,000 lekë. Mendimi ndryshe është paraqitur në faqen zyrtare të internetit si dhe në buletin zyrtar të Autoritetit të Konkurrencës.

Ndërmarrjet e kanë ankimuar vendimin nr. 154, datë 01.10.2010 të Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës lidhur me gjobën për pjesëmarrje në marrëveshjen e ndaluar në oferta. Kjo çështje është ende në gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

• **Hetimi Paraprak në Tregun e Prodhimit dhe Tregtimit të Bukës në Qarkun e Korçës**

Autoriteti i Konkurrencës bazuar në informacionin e marr nga media mbi rritjen e çmimit të bukës të njoftuar në emër të shoqatës së prodhuesve të bukës të Qarkut të Korçës, vendosi për hapjen e hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në Qarkun e Korçës, për të vërtetuar ekzistencën ose jo të një marrëveshje të ndaluar në kuptim të Ligjit "Për mbrojtjen e Konkurrencës". Në vazhdim të procedurave inspektorët e autoritetit realizuan inspektime të menjëhreshme në terren. Gjithashtu, u siguruan të dhëna dhe informacione nga: Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçe, Bashkia Korçë, Kolonjë, Pogradec dhe Devoll. Gjithashtu, u realizuan disa inspektime në ndërmarrjet që operojnë në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në Qarkun Korçë. Më datë 31.05.2010 u organizua një seancë nga Komisioni i Konkurrencës me prodhuesit dhe tregtuesit e bukës në Qarkun e Korçës, në të cilën morën pjesë disa prej tyre. Organizimi i seancës u bë me qëllim identifikimin e faktorëve që ndikojnë në nivelin e konkurrencës në tregun përkatës objekt hetimi. Në vijim të procedurave, Komisioni i Konkurrencës, bazuar në Raportin e Sekretariatit "Mbi hetimin paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në Qarkun e Korçës" dhe argumentave të palëve paraqitura gjatë seancës dëgjimore, në mbështetje të nenit 24, shkronja d) dhe 45 paragrafi 2, të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", vendosi, me shumicë votash, mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në Qarkun e Korçës dhe pranimin e angazhimeve të palëve për rivendosjen e konkurrencës në treg, me anë të Vendimit Nr. 146, datë 17.06.2010 "Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në Qarkun e Korçës".

Komisioni i Konkurrencës duke marrë shkasë nga ky rast, në zbatim të Politikës dhe Ligjit "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", realizoi një njoftim për shtyp duke tërhequr vëmendjen e shoqatave të biznesit që në veprimtarinë e tyre të mbrojnë interesat e antarëve sipas ligjit dhe të mos ndikojnë në vendosjen e praktikave të bashkërenduara/të koordinuara për rritje të menjëhershme të çmimeve, fiksime çmimesh apo ndarje tregu.

- **Praktika gjyqësore në rastet e marrëveshjeve të ndaluara**

Gjatë vitit 2010, Sekretariati i Autoritetit kanë realizuar mbrojtjen e vendimeve të komisionit, të cilat janë goditur në gjykatë nga palët e prekura. Kështu, ndërmarrja “Bloja” sh.a ka apeluar vendimin Nr. 125 datë 08. 10.2009 të Komisionit të konkurrencës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo gjykatë vendosi “për pranimin e padisë”, vendim i cili është ankimuar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Komisioni i Konkurrencës, deri në fillim të 2011, nuk ka mundur të zotërojë formatin e zbardhur të vendimit të Gjykatës së Tiranës, pavarësisht se procesi gjyqësor ka përfunduar në mes të muajit Prill, 2010. Edhe “Atlas” sh.a e ka çuar çështjen pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me objekt shfuqizim (anullim) i pjesëshëm i vendimit Nr. 125 datë 08. 10.2009 të Komisionit të Konkurrencës. Edhe ky trup gjykues vendosi për “pranimin e padisë”, fakt i cili do të sjelli ankimin e këtij vendimi pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

1.2 Abuzimi me pozitën dominuese

- **Hetimi i thelluar në tregun e prodhimit në vend të produktit lëndë djegëse Diesel (D2).**

Procedurat e monitorimit, hetimit paraprak dhe fillimi i hetimit të thelluar në tregun e prodhimit në vend dhe e tregëtimit të produktit lëndë djegëse për automjete Diesel filluan në vitin 2009 dhe përfunduan gjatë vitit 2010. Në përfundim të hetimit të thelluar Sekretariati argumentoi se ndërmarrja “Armo” sh.a kishte abuzuar me pozitën dominuese në tregun përkatës të produktit lëndë djegëse diesel D2 pasi për veprime tregtare të njëjta kishte aplikuar çmime të ndryshme në ditë të njëjta ndaj ndërmarrjeve të tjera që operonin në tregun e tregtimit të karburantit Diesel D2 me shumicë. Në kuptim të nenit 9, pikës 2, gërmës (c), të Ligjit 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, kjo shoqëri kishte vepruar në shkelje të ligjit.

Komisioni i Konkurrencës bazuar në raportin e hetimit të thelluar dhe në pretendimet e shoqërisë të paraqitura me shkrim dhe në mënyrë verbale në seancën dëgjimore të organizuar, në zbatim të nenit 39 të Ligjit, vendosi me anë të vendimit Nr. 150, datë 20.07.2010, se ndërmarrja “Armo” sh.a ka abuzuar me pozitën dominuese. Abuzimi me pozitën dominuese u vërtetua për periudhën 1 janar 2009 - 22 gusht 2009, në tregun e produktit lëndë djegëse diesel D2, duke vendosur kushte të pabarabarta tregtimi ndaj ndërmarrjeve të ndryshme për të njëjtat veprime tregtare. Për shkeljen e konstatuar, ndërmarrja “Armo” sh.a u penalizua për shumën 271,880,720 Lekë.

Shoqëria “Armo” sh.a ka kundërshtuar në rrugë gjyqësore vendimin Nr. 150, datë 27.07.2010 të Autoritetit të Konkurrencës. Kjo çështje është ende në gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

• **Hetimi i thelluar në tregun e ngarkim shkarkim dhe depozitim i gazit të lëngshëm të naftës (GLN)**

Gjatë vitit 2010 Autoriteti i Konkurrencës, bazuar në ankesat e operatorve të importit të gazit të lëngshëm të naftës dhe në shqetësimet e OSHA, realizoi monitorimin, hetimin paraprak dhe hetimin e thelluar në tregun e ngarkim, shkarkim dhe depozitim të gazit të lëngshëm të naftës (GLN) në rrugë bregdetare.

Gjatë procedurave hetimore u konstatua se importi i gazit të lëngshëm në rrugë detare realizohej vetëm në 2 (dy) Porte, përkatësisht Porti “Vlora-1” dhe Porti “Porto Romano”, të dhëna me koncesion nga shteti Shqiptar, me ekskluzivitet në zonat përkatëse gjeografike. Gjithashtu u evidentua rritja e ndjeshme e shkallës së përqëndrimit në tregun e importit të GLN-së. Pas vlerësimit të materialeve të administruara gjatë inspektimeve Sekretariati hartoi Raportin “Për Marrjen e Masave të Përkohshme në Tregun e Shërbimit të Ngarkim-Shkarkimit dhe Depozitimit të Gazit të Lëngshëm”, duke i propozuar Komisionit të Konkurrencës marrjen e masave të përkohshme

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të Raportit dhe dëgjimit të palëve në seancën e organizuar, bazuar në nenin 24 gërma d dhe nenin 44 të Ligjit u shpreh me anë të vendimit Nr. 140, datë 10.03.2010, “Për marrjen e masave të përkohshme në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm”, duke synuar ndërhyrjen sa më shpejt në treg..

Sekretariati gjatë hetimit paraprak vlerësoi sjelljen e ndërmarrjeve (1)PIA sha në tregun e ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të GLN,(2) “Romano Port” sh.a në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të gazit të lëngshëm dhe (3) “Inter Gaz” sh.a në tregun e shërbimit të depozitimit të gazit të lëngshëm dhe u shpreh se këto shoqëri mund të kenë abuzuar me pozitën e tyre dominuese në tregjet përkatëse me anë të kushteve të vendosura për ofrimin e shërbimit, sipas nenit 9, pika 2, të Ligjit.

Në vijim të procedurave Komisioni i Konkurrencës me anë të vendimit Nr 147, datë 23.06.2010 vendosi hapjen e hetimit të thelluar në tregun e ngarkim, shkarkim dhe depozitimit të gazit të lëngshëm në rrugë detare.

Grupi i punës pas përfundimit të procedurat hetimore hartoi raportin përfundimtar ku rezultoi se (i) ndërmarrja “PIA” Sh.a ka pozitë dominuese në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm, (ii) ndërmarrja Romano Port Sh.a ka pozitë dominuese në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të gazit të lëngshëm si dhe (iii) ndërmarrja Intergaz SHA ka pozitë dominuese në tregun e shërbimit të depozitimit të GLN-së në zonën e Porto-Romano Durrës. Gjithashtu, Sekretariati pretendonte se nga vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjes PIA sha në tregun e Ngarkim-Shkarkimit dhe Depozitimit të GLN-së, rezulton se kjo ndërmarrje, bazuar në nenin 9, pika 2, gërma d, të ligjit 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, ka abuzuar me pozitën e saj dominuese në këtë treg, me anë të kushteve të vendosura për ofrimin e shërbimit.

Në zbatim të nenit 39 të Ligjit Komisioni i Konkurrencës organizoi seancat dëgjimore me palët objekt hetimi. Raporti ju dërgua palëve nën hetim të cilat paraqitën pretendimet e tyre me shkrim dhe në mënyrë verbale gjatë seancave dëgjimore. Në vijim të procedurave, bazuar në raportin e hetimit të thelluar dhe në pretendimet e palëve, Komisioni i Konkurrencës konkludoi se ndryshimet strukturore në tregun e ngarkim-shkarkimit dhe të depozitimit të gazit të lëngshëm të naftës në rrugë detare kanë shkaktuar një vend të ngushtë(Bottle-Neck) dhe rrjedhimisht kanë shkaktuar edhe

ndryshime strukturore në rritjen e shkallës së shkallës së përqëndrimit në tregun e importit të GLN-së. Palët si në ofrimin e shërbimit nëpërmjet terminaleve bregdetare ashtu dhe në realizimin e kërkesës nuk kanë bashkëpunuar për të realizuar një zhvillim të qëndrueshëm dhe me kosto të arsyeshme ekonomike.

Komisioni konkludoi se ndërmarrjet objekt hetimi nuk kanë abuzuar me pozitën dominuese dhe vendosi mbylljen e hetimit të thelluar për ndërmarrjet 'La Petrolifera Italo – Albanese' sh.a, 'Romano Port' sh.a dhe 'Intergaz'sh.a me anë të Vendimit Nr 162, datë 14.12.2010.

- **Hetimi i thelluar në tregun e bonove të thesarit**

Në fund të vitit 2009 Sekretariati përfundoi hetimin e thelluar në lidhje me abuzimin e mundshëm me pozitën dominuese të Raiffeisen Bank në tregun e bonove të thesarit. Në mars të vitit 2010 Komisioni i Konkurrencës pasi organizoi seancën dëgjimore të palës nën hetim u shpreh me anë të Vendimit Nr. 142, datë 15.03.2010 ku vendosi mbylljen e hetimit të thelluar ndaj "Raiffeisen Bank" Sh.a për abuzim me pozitën dominuese në tregun primar dhe sekondar të bonove të thesarit dhe përcaktimi i kushteve dhe detyrimeve për "Raiffeisen Bank" Sh.a".

Me anë të këtij vendimi Komisioni i Konkurrencës vendosi kushte dhe detyrime ndaj Raiffeisen Bank SHA mbi bazën e angazhimeve të shprehura nga banka në seancën dëgjimore. Bankës Raiffeisen iu imponua nëpërmjet vendimit se duhet të ulë komisionet që i tarifohen individëve në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në tregun primar. Këto komisione duhet të ulen në masën 50%, për një periudhë 3 vjeçare, me qëllim që të nxitet dhe të rritet pjesëmarrja e individëve në tregun primar.

Gjithashtu sipas vendimit të Komisionit Raiffeisen duhet të bëjë korrigjimet për të përmirësuar dhënien e informacionit mbi BTH tek publiku duke hartuar ad hoc material mbi marketingun që do të ekspozohet dhe/ose shpërndahet në secilën prej degëve të saj si dhe të shfaqte në mënyrën e duhur tendencat e yield-it të BTH të përditësuara në kohë, si dhe të informacioni rreth BTH do të jetë i publikuar në faqen e internetit të RB nëpërmjet një linku të identifikueshëm.

Duhet theksuar se gjatë vitit 2010 ka patur një rënie në normën e interesit të bonove të thesarit me rreth 2% dhe ka patur një rritje të ndjeshme të numrit të individëve pjesëmarrës në ankandet e bonove të thesarit.

Gjatë vitit 2010 Sekretariati kërkoi nga Banka Raiffeisen informacion në lidhje me zbatimin e Vendimit Nr 142 të Komisionit të Konkurrencës. Nga informacioni i ardhur u informua se Raiffeisen Bank ka miratuar uljen e komisioneve nga 1.2% në 0.6%, ka përgatitur një broshurë informuese për bonot e thesarit të cilën e ka vendosur në të gjitha pikat. Gjithashtu RB në faqen e internetit ka publikuar të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me bonot e thesarit.

Për sa më sipër rezulton se Raiffeisen Bank ka plotësuar të gjitha kushtet dhe detyrimet e vendosura nga Autoriteti i Konkurrencës.

- **Hetimi paraprak ndaj shoqërisë 'Digitalb' sh.a në tregun e ofrimit të paketës televizive me pagesë 'Premium'**

Gjatë muajit shtator të 2010-tës, pranë Autoritetit të Konkurrencës, u depozitua ankesa në lidhje me abuzimin e mundshëm me pozitën dominuese të ndërmarrjes Digitalb sh.a.

Pas shqyrtimit të kësaj ankese, Sekretari i Përgjithshëm, me anë të vendimit Nr 11, datë 28.09.2010, vendosi hapjen e hetimit paraprak ndaj shoqërisë Digitalb sh.a në tregun e ofrimit të paketës televizive me pagesë 'Premium'. Në përfundim të këtij hetimi rezultoi se ndërmarrja Digitalb sh.a zotëron pozitë dominuese në tregun e ofrimit të paketës televizive me pagesë 'Premium' por nuk rezultoi asnjë shkelje e nenit 9 lidhur me abuzimin me pozitën dominuese.

Për këto arsye Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit Nr 163, datë 14.12.2010 vendosi mbylljen e hetimit paraprak në tregun e ofrimit të paketës televizive me pagesë 'Premium' ndaj Digitalb sh.a.

- **Hetimi paraprak në tregun e internetit**

Autoriteti i Konkurrencës, bazuar në konkluzionet e dala nga Raporti i analizës së tregut të shumicës të aksesit në Broadband dhe aksesit në infrastrukturën fizike (LLU) të hartuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për tregun e internetit, nisi procedurat e hetimit paraprak për ndërmarrjen Albtelekom sh.a në tregun e internetit. Procedura e hetimit paraprak në tregun e internetit është ende në proces.

- **Rishikimi i vendimeve për abuzimin me pozitë dominuese në rrugë gjyqësore**

Pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, në vitin 2010 u gjykua çështja civile me: "AMC" SHA versus Autoriteti i Konkurrencës, me objekt Pavlefshmëri e Vendimit Nr.59 datë 09.11.2007 të Komisionit të Konkurrencës. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në vitin 2009 vendosi për rrëzimin e kërkesë padisë; Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin e saj të vitit 2010 vendosi: "Lënien në Fuqi të Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë". Përfundimisht, me vendim të formës së prerë të gjykatave, vendimi i Komisionit të Konkurrencës Nr. 59 datë 09.11.2007 "për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjes AMC SHA dhe Vodafone Albania SHA", vetëm për pjesën që i përket AMC është lënë në fuqi. Nga ana e Autoritetit të Konkurrencës, janë ndjekur procedurat përkatëse për lëshimin e urdhrat të ekzekutimit, e më pas i është drejtuar Zyrës Përmbartimore Tiranë për ekzekutimin e këtij vendimi. Aktualisht kjo çështje është duke vazhduar procedurat e ekzekutimit nga ana e Zyrës Përmbartimore Tiranë. Ndërkohë që për pjesën e Vodafone Albania SHA Autoriteti i Konkurrencës është në pritje të datës së gjykimit nga Gjykata e Apelit Tiranë.

1.3 Kontrolli i Përqëndrimeve

Në politikën e konkurrencës, të parë nga këndvështrimi i eficiencës së tregut dhe përfitimeve për konsumatorët, përqëndrimet e ndërmarrjeve përgjithësisht pranohen si të dëshirueshme për shkak të eficiencës në reduktimin e kostove. Megjithatë, gjatë vlerësimit nuk duhen anashkaluar pasojat negative që ato shkaktojnë, nga krijimi ose forcimi i pozitës dominuese të ndërmarrjes së përqëndruar. Ndryshimi i strukturës së tregut, i shkaktohet nga një përqëndrim duhet analizuar në dy drejtime:

- a) kur ndryshimi pas përqendrimit vjen si rezultat i rritjes nga jashtë, që do të thotë të përfitimeve të kontrollit nga ndërmarrje jashtë tregut territorial vendas dhe
- b) kur rritja vjen si rezultat i përfitimeve të kontrollit apo bashkimeve ndërmjet ndërmarrjeve që veprojnë në tregun e brendshëm, apo kur ndërmarrjet e gëzonin këtë pozicion (si në rastin e monopolit natyral).

Gjatë vitit 2010 Komisioni i Konkurrencës ka autorizuar 6 përqendrime si dhe ka dhënë sqarimet për lejimin e disa transaksioneve që nuk ndryshonin kontrollin e ndërmarrjeve objekt përqendrimi ose nuk përmbushej kushti i xhiros minimale të parashikuara në ligj, që përqendrimi të ishte objekt i autorizimit nga ana e Komisionit të Konkurrencës.

shimi i kontrollit si pasojë:	Nr i përqendrimeve të autorizuar
m i dy ose më shumë ndërmarrje ose pjesë arrjesh të pavaruara nga njëra tjetra	0
kontrolli (i drejtpërdrejtë ose i tërthortë) të një ë shumë ndërmarrjeve ose të një pjese të të fundit	5
i një ndërmarrje të përbashkët, që kryen të unksionet e një njësie ekonomike të pavarur	1
epj	6

T
a
b
e
l
a
N

r 1: Ndryshimi i cilësisë së kontrollit

- **Në sektorin e energjisë**

Në sektorin e energjisë është realizuar përqendrimi ndërmjet ndërmarrjeve Energji Ashta Sh.p.k, nga VERBUND International GbmH dhe EVN AG i autorizuar nga Komisioni i Konkurrencës me Vendim nr. 152 Datë 21.07.2010 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shit - blerjes së 50% të Kuotave të shoqërisë Energji Ashta Sh.p.k, nga VERBUND International GbmH tek EVN AG”, pasi transaksioni nuk krijon pozitë dominuese të shoqërisë pas përqendrimit.

- **Tregu i aromatizuesve të ajrit**

Vendimi nr. 139 Datë 24.02.2010 “Mbi autorizimin e përqendrimit për përfitim e plotë të kontrollit nga Procter & Gamble Group, në Sara Lee Group, realizuar nëpërmjet blerjes së 100% aseteve të shoqërisë target Sara Lee Air Care”. Ky transaksion konsiston në përfitim e plotë të kontrollit nëpërmjet blerjes së 100% të veprimtarisë ekonomike (biznesit) të ndërmarrjes Sara Lee Air Care, për prodhimin dhe tregtimin

mbarë kombëtar të produkteve të aromatizuesve të ajrit nën markën Ambi Pur. Analiza e transaksionit tregoi se nuk ka lidhje shkakësore midis realizimit të këtij përqendrimi dhe krijimit ose forcimit të pozitës dominuese në tregun e brendshëm për ndërmarrjet objekt përqendrimi.

- **Tregu për shërbime dhe produkte të komunikimit dhe teknologjisë së informacionit**

Në këtë treg janë realizuar 2 përqendrime dhe të dy nga e njëjta ndërmarrje përthithëse Harris Corporation Inc. dy përqendrime të cilët janë autorizuar nga Komisioni i Konkurrencës me: Vendimin nr. 151 Datë 21.07. 2010 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes së 100 % të aksioneve në ndërmarrjen CapRock Holdings, Inc. nga ndërmarrja Harris Corporation”; dhe Vendimin nr. 166 Datë 21.12. 2010 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së aktivitetit të shoqërisë Global Connectivity Services nga shoqëria Harris Corporation”.

Bazuar në analizën u konstatua se të dyja transaksionet nuk krijojnë ose forcojnë pozitën dominuese të produkteve të Harris Corporation në nivelin e tregtimit në tregun e brendshëm.

- **Tregu i lojrave të fatit**

Vendimi nr. 153 Datë 21.07. 2010 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes së 100 % të aksioneve mbi shoqërinë Astra Albania Sh.a nga shoqëria Eagle Investment Sh.a”. Gjatë vlerësimit të këtij transaksioni u konstatua se ndërmarrja Eagle Investment Sh.a me anë të këtij përqendrimi së bashku me aksionet ka përfutur edhe kontrollin e vetëm në shoqërinë Astra Albania Sh.a., e cila tashmë ka në zotërim në këtë treg si ndërmarrjen Adriatik Game Sha ashtu edhe Astra Albania Sha.

Të dyja shoqëritë Adriatik Game Sha dhe Astra Albania Sha veprojnë në të njëjtin nivel tregu të produktit dhe kanë një marrëdhënie horizontale. Bashkimi i këtyre dy shoqërive ka rritur fuqinë e ndërmarrjes pas realizimit të përqendrimit, me një pjesë të kombinuar të tregut prej afërsisht 10.4%. Në këtë treg veprojnë një numër i madh shoqëriish relativisht të vogla të shpërndara në të gjithë territorin gjeografik të Republikës së Shqipërisë, ndërkohë që pas përqendrimit ka 5 konkurrentë kryesorë në këtë treg, ku asnjëri prej tyre nuk ka pozitë dominuese. Përqendrimi në fjalë nuk ka krijuar pozitë dominuese në tregun përkatës apo në një pjesë të tij.

- **Tregu i sigurimeve**

Në fushën e sigurimeve është realizuar një përqendrim i cili është autorizuar nga Komisioni i Konkurrencës me Vendim nr. 160 Datë 23.11.2010 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së 75%+1 aksione të shoqërisë InterAlbanian Sh.a nga shoqëria Vienna Insurance Group AG”

Përqendrimi i realizuar është përfundim i kontrollit të vetëm, dhe përsa kohë përfituesi i kontrollit Vienna Insurance Group ka qenë prezent në treg nëpërmjet një ndërmarrje konkurrese (Sigma Sh.a) me ndërmarrjen InterAlbanian Sh.a, ky përqendrim është vlerësuar veçanërisht në lidhje me dominancën e mundshme të

ndërmarrjeve pas përqendrimit, pasi pjesa e kombinuar e pjesëve të tregut të ndërmarrjes përfutuese të kontrollit pas përqendrimit arrin në mbi 25% të tregut përkatës. Nga analiza e tregjeve të prekura rezulton se grupi Vienna Insurance do të zotërojë kontrollin në dy shoqëri konkurruese në nivel horizontal të tregut, Interalbani sh.a dhe Sigma sh.a, por nuk shfaqen shenja të kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti.

- **Raste të ndryshme që nuk janë konsideruar objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.**

- **Në tregun e sigurimeve**

Në këtë treg është shqyrtuar rasti mbi bashkimin me përthithje të ndërmarrjeve Sigal Uniqa Group Austria Sh.a dhe Sigal Holding Sh.a i cili ka sjellë një ndryshim të strukturës brenda Grupit Sigal Uniqa (*përthithje e filialit të njëjtë grup*), por pa ndryshuar cilësinë e kontrollit të ndërmarrjes së përthithur. Ky rast, i cili nuk ka ndryshuar formën dhe cilësinë e kontrollit në ndërmarrjen e përthithur dhe në kuptim të nenit 10, pika 2, shkronja a) e Ligjit, nuk është konsideruar përqendrim. Për këtë palët janë njoftuar me anë të një letre qetësuese, se ky rast nuk konsiderohet përqendrim dhe si rrjedhojë nuk ka nevojë për t'u autorizuar nga Komisioni i Konkurrencës.

- **Në tregun e prodhimit dhe tregtimit të çelikut**

Rasti i përfutimit të kontrollit të ndërmarrjeve IISW dhe CJSC nga ndërmarrja Metinvest B.V, i cili është mbyllur me letër qetësuese, mbasi nuk është konsideruar përqendrim, i cili hyn në fushën e zbatimit të Ligjit (objekt i transaksionit është përfutimi i kontrollit të ndërmarrjeve jashtë tregut gjeografik të Shqipërisë) dhe nuk është objekt për dhënien e autorizimit nga Komisioni i Konkurrencës.

- **Në tregun e telekomunikacioneve**

Rasti CETEL CE/ Telemed Telekom, i paraqitur në formën e ristrukturimit brenda Grupit CETEL ku bën pjesë edhe ndërmarrja shqiptare Albetelekom. Në këtë rast transaksioni nuk ka sjellë asnjë pasojë në strukturën e tregut të telekomunikacioneve apo në cilësinë e kontrollit të Albetelekom Sh.a. dhe nuk është konsideruar përqendrim në kuptim të Ligjit, si dhe nuk ka qenë objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

- **Në tregun bankar**

Në tregun bankar është njoftuar transaksioni objekt i blerjes së 7.78% të aksioneve të Intesa SanPaolo Bank Albania Sh.a në pronësi të Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) nga Intesa SanPaolo S.p.A. Ky transaksion nuk është konsideruar përqendrim pasi nuk ka ndryshuar strukturën e kontrollit brenda ndërmarrjes Intesa SanPaolo Bank Albania Sh.a (ndërmarrja Intesa SanPaolo S.p.A. ka kontrolluar këtë ndërmarrje që nga viti 2007). Komisioni i Konkurrencës është shprehur me anë të një letre sqaruese lidhur me transaksionin mbi transferimin duke mos e konsideruar këtë rast si përqendrim në kuptim të nenit 10 të Ligjit.

- **Në tregun e energjisë elektrike**

Në kuadër të përqendrimit të ndodhur midis ndërmarrjeve Energji Ashta Sh.p.k, nga VERBUND International GbmH dhe EVN AG i autorizuar nga Komisioni i Konkurrencës me Vendim nr. 152, datë 21.07.2010, është njoftuar edhe transferimi i 50% te kuotave te shoqërisë Ashta Sh.p.k. nga shoqëria Verbund International GmbH ne favor te shoqërisë Verbund –Austrian Hydro Power AG. Nga vlerësimi ligjor ka rezultuar se ky transaksion shfaqet si nje ristrukturim brenda Grupit Verbund, i cili nuk ka ndryshuar strukturën kontrollit të shoqërisë shqiptare Energji Ashta Sh.p.k. dhe nuk është përqendrim në kuptim të Ligjit. Palëve i është dërguar një letër sqaruese se transaksioni nuk është objekt për dhënien e autorizimit nga Komisioni Konkurrencës.

1.4 Studimi dhe monitorimi i tregut

Gjatë vitit 2010, Autoriteti i Konkurrencës ka patur si objektiv monitorimin e kushteve të tregut për funksionimin e konkurrencës së lirë dhe efektive, e cila është realizuar kryesisht nga Sektori i analizës dhe i studimit të tregut. Analiza e sektorëve kryesorë të ekonomisë si dhe tregjeve më të ekspozuara nga praktikant antikonkurrese për shkak të numrit të vogël të konkurrentëve dhe/ose kërkesës së fortë kanë qenë objekt i monitorimit të vazhdueshëm nga ana e Autoritetit të Konkurrencës.

- **Studimi i tregut të shërbimeve bankare**

Monitorimi i tregut të shërbimeve bankare ka filluar në vjeshtën e vitit 2009 dhe përfundoi në tremujorin e parë te vitit 2010. Qëllimi i monitorimit ishte vlerësimi i sjelljes së bankave të nivelit të dytë në lidhje me transparencën dhe nivelin e tarifave të shërbimeve bankare.

Për realizimin e objektivit, grupi i punës u bazua mbi studimet e tregut të shërbimeve bankare të realizuar nga Komisioni European dhe OECD. Monitorimi i tregut të shërbimeve bankare u fokusua në dy drejtime: studimi i transparencës se bankave në lidhje me publikimin dhe informimin e klientëve dhe niveli i tarifave te shërbimeve dhe produkteve. Në përfundim të monitorimit nga Grupi i Punës u konkludua se bankat e nivelit të dytë aplikojnë tarifa të ndryshme për shërbime të njëjta. Nga vlerësimi i treguesve të transparencës u konstatua se jo të gjitha bankat e nivelit të dytë kishin faqe interneti dhe si rrjedhojë nuk kishin të publikuara kushtet e punës. Bankat nuk i njoftonin klientët kur ndryshonin kushtet e punës për kontratat e shërbimeve, gjë e cila tregon një nivel te ulet te transparencës se bankave. Nga krahasimi i tarifave të shërbimeve me bankat e Rajonit, brenda të njëjtit grup bankar, u konstatua së të gjitha bankat që operojnë në Shqipëri aplikojnë tarifa më të larta të shërbimeve bankare sesa bankat homologe ne rajon, kryesisht kjo për komisionet fikse.

Raporti u konsultua me palët e interesit, Bankën e Shqipërisë dhe Komisionit për Mbrojtjen e Konsumatorit pranë METE-së, me të cilët u organizua një seancë konsultative me Komisionin Konkurrencës. Në muajin Janar 2011 Komisioni i Konkurrencës u shpreh me vendim duke dhënë disa rekomandime për Bankën e Shqipërisë dhe Komisionin e Mbrojtjes Konsumatore.

- **Studimi i tregut farmaceutik.**

Tregu farmaceutik është vlerësuar disa here nga Autoriteti i Konkurrencës në mënyrë të fragmentuar. Për një vlerësim sa më të orientuar, u patën parasysh hetime dhe studime të kryera nga Drejtoria e përgjithshme e Konkurrencës, Komisioni Evropian. Monitorimi i këtij tregu pati si qëllim vlerësimin e importit dhe rrjetin e hapur të farmacive të tregtimit të medikamenteve. Si një treg i rregulluar nga legjislacioni primar dhe sekondar dhe i kontrolluar nga disa institucione, monitorimi pati dy objektiva: (i) vlerësimi i legjislacionit mbi të cilën funksiononte tregu i barnave me/pa rimbursim dhe (ii) vlerësimi i strukturës së tregut të importit të medikamenteve dhe analiza e konkurrencës.

Pas seancave konsultative të mbajtura nga Komisioni i Konkurrencës me përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Insitutit e Sigurimeve Shëndetësore (ISKSH), Grupi i Punës rivlerësoi propozimet e shprehura në raportin e monitorimit dhe shprehu mendimin se nuk ishte me e nevojshme dhënia e një rekomandimi për ndryshim të nenit 20, pika 2, b) e Ligjit nr 9323, datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”.

- **Monitorimi i tregut të produkteve ushqimore**

Rritja e indeksit të çmimeve për disa nga produktet ushqimore gjatë vitit 2010 u bë shkak për fillimin e një monitorimi të tregut të sheqerit, orizit dhe vajit ushqimor. Qëllimi i monitorimit ishte evidentimi i strukturës së tregut dhe vlerësimi i trendit të çmimit të importit të këtyre produkteve. Për vetë specifikat e produktit sheqer dhe oriz (kërkesa për të cilat mbulohet vetëm nga importi), monitorimi u fokusua në tregun e importit të sheqerit dhe orizit, kurse tregu i vajit do të përfshinte si importin edhe prodhimin në vend të vajit ushqimor.

Pas përpunimit të të dhënave dhe vlerësimit të treguesve të konkurrencës, u konstatua se rritja e fortë e çmimeve në të tre tregjet e produkteve ushqimore dhe shkalla e lartë e përqendrimit të tyre, japin indikacione të mjaftueshme për kufizime të mundshme të konkurrencës në këto tregje dhe për këtë arsye Komisioni i Konkurrencës miratoi propozimin e Sekretariatit për hapjen e hetimit paraprak respektivisht në tregjet e importit dhe tregtimit me shumicë të sheqerit, orizit, tregëtimit me shumicë të vajit vegjetal. Periudha e hetimit do të jetë nga 1 Janari 2008 deri më 31 tetor 2010. Kjo procedurë është ende në vazhdim dhe pritet të përfundojë brenda 3 muajve të parë të vitit 2011.

- **Mbi monitorimin e kufizimeve të mundshme të konkurrencës në tregjet përkatëse të profesioneve të lira**

Sikurse është paraqitur në raportin e vitit 2009, Sekretariati ka monitoruar dhe analizuar kushtet e tregut lidhur me kufizimin e konkurrencës në tregjet përkatëse të profesioneve të lira si: shërbimi i noterisë, avokatisë, farmacistëve, stomatologëve, eksperteve kontabël të autorizuar dhe kontabilistëve të miratuar.

Monitorimi konsistoi shqyrtimin e kufizimeve për eliminimin e tyre në fushën e shërbimeve profesionale si pasoje e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, për shkak se këto tregje karakterizohen në përgjithësi nga nivele të larta rregullimi nga aktet ligjore dhe nënligjore. Janë pesë kategori të kufizimeve që konsiderohen të rëndësishme nga Komisioni Evropian për profesionet e lira: çmimet e fiksuara, çmimet e rekomanduara, rregullat e reklamës, kërkesat e hyrjes & të drejtat e rezervuara dhe praktikat dhe

rregullat që udhëheqin biznesin, të cilat mund të eliminojnë/kufizojnë konkurrencën midis ofertuesve të shërbimit.

Komisioni i Konkurrencës pas vlerësimit të raportit të Sekretariatit në muajin shkurt 2010 konstatoi se: nga informacioni i grumbulluar, baza ligjore e funksionimit si dhe nga studimi i rasteve të ngjashme për profesionet e lira, vihet re se mënyra e funksionimit dhe baza ligjore janë përafëruar me ato të vendeve të BE-së.

- **Monitorimi në tregun e energjisë elektrike**

Gjatë vitit 2010, tregu i energjisë elektrike ka qënë objekt monitorimi të vazhdueshëm nga Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut. Qëllimi i monitorimit të tregut të energjisë elektrike ishte mbikëqyrja e sjelljes së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes pas privatizimit. Gjatë këtij monitorimi u paraqitën dy raporte përkatësisht për pjesën e rregulluar dhe për pjesën e parregulluar të tregut të energjisë. Në përfundim të këtij monitorimi, me anë të vendimit Nr. 159, datë 19.11. 2010 “Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e energjisë elektrike” Komisioni i Konkurrencës, me shumicë votash, vendosi t’i rekomandojë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Entit Rregullator të Energjisë Elektrike ndarjen funksionale dhe financiare reale të “Furnizuesit Publik me Shumicë” nga KESH-Gen, e cila do të krijojë kushtet për konkurrencë në këtë nivel tregu për të gjithë të interesuarit (PPE, PVE, Furnizuesit e Kualifikuar) për të kryer transaksione konkurruese dhe është në zbatim të modelit të tregut si dhe ndarjen financiare reale të “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” dhe “Furnizuesit Publik me Pakicë” në mënyrë që të operojnë si njësi të ndara financiarisht, pasi këto segmente tregu janë të liberalizuara dhe është një instrument që ndikon në rritjen e konkurrencës.

Gjithashtu Komisioni i Konkurrencës rekomandoi përshejtimin e procesit të rishikimit të kontratës me klientët tariforë, duke përcaktuar detyrimet e Furnizuesit Publik me Pakicë për mbrojtjen e konsumatorit nëpërmjet respektimit të treguesve të cilësisë së shërbimit (furnizimi vs mungesës së energjisë dhe saktësisë së faturimit).

- **Monitorim në tregun e tregtimit të pajisjeve fiskale.**

Autoriteti i Konkurrencës, duke marrë shkas nga kronikat dhe prononcimet e ndryshme në median vizive dhe të shkruar në lidhje me problematikën në procesin e tregtimit të pajisjeve fiskale si dhe pas depozitimit pranë Autoritetit të Konkurrencës të një letre anonime me Nr. Prot. 337, dt. 20.08.2010 dhe ankesës së Zyrës Shqiptare të Konsumatorit, realizoi një monitorim në tregun e tregtimit të pajisjeve fiskale për të parë nëse ka elementë të kufizimit të konkurrencës.

Autoriteti i Konkurrencës monitoroi kufizimet e mundshme të konkurrencës në këtë treg pas daljes së Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 16 datë 03.05.2010 “Për administrimin dhe dokumentimin e procedurave të pajisjeve fiskale”.

Për shkak të ndryshimit të legjislacionit dhe kohës së nevojshme për përshtatjen e pajisjeve fiskale nga ana e ndërmarrjeve me kërkesat e reja, ky treg për një periudhë 4 mujore ka patur si aktorë të tij vetëm dy ndërmarrje dhe në muajin shtator 2010 ka plotësuar kriteret edhe ndërmarrja e tretë për pajisjet e saj fiskale. Nga të dhënat e analizuara në raport del se tregu ka një përqendrim të lartë, që vjen kryesisht për shkak të numrit të pakët të operatorëve (aktualisht vetëm tre të licencuar) që veprojnë pas Udhëzimit të ri të Ministrit të Financave Nr. 16 datë 03.05.2010.

Nga të dhënat e siguruar nga ndërmarrjet për çmimet e shitjes së kasave fiskale si edhe nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, konstatohet se çmimet në treg për kategori të njëjta të kasave janë të ndryshme. Ndërmarrjet aplikojnë çmime të diferencuara nga njëra tjetra, duke u bazuar kryesisht në kostot dhe cilësinë e produkteve që ato tregtojnë.

Komisioni i Konkurrencës pas vlerësimit të këtij raporti konstatoi se në këtë treg nuk ka shkelje të Ligjit 9121, 23.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës".

- **Monitorime në vazhdimësi të disa tregjeve objekt hetimi.**

Përveç studimeve të mirëfillta nga Sektori i Analizës janë kryer monitorime të vazhdueshme për tregje të cilat kanë qene objekt hetimi si:

- ***Tregu i importit të grurit.***

Ky monitorim përfshiu periudhën deri në gusht 2010 dhe ishte në vazhdim të monitorimeve të mëparshme dhe në funksion të hetimit paraprak në tregun e prodhimit të bukës në Qarkun e Korçës. Monitorimi i mëtejshëm i këtij tregu është pjesë e planit të punës së këtij sektori.

- ***Tregu i importit të karburanteve***

Monitorimi i tregut të importit të karburanteve vlerësoi tendencën e tregut të importit të karburanteve për muajt Janar- Gusht 2010. Nga vlerësimi i të dhënave nuk u konstatuan shenja të dukshme të kufizimit të konkurrencës si pasojë e sjelljes së ndërmarrjeve në treg. Procesi i monitorimit të këtij tregu është i vazhdueshëm.

- ***Tregu i importit të gazit të lëngshëm.***

Tregu i importit të gazit të lëngshëm filloi si një monitorim në funksion të hetimit në tregun e ngarkim shkarkimit të gazit. Qëllimi i monitorimit ishte evidentimi i strukturës së tregut të importit për faktin se dy kompanitë e shkarkimit operonin edhe në tregun e importit të gazit. Analiza dhe raportet përkatëse u vunë në funksion të grupeve të punës që ndoqën hetimin. Edhe pas mbylljes së hetimit, nga ana e Sektorit të Analizës vazhdon monitorimi i tregut të importit të gazit me qëllim vlerësimin e sjelljes së ndërmarrjeve të importit dhe tregtimit me shumicë të gazit. Të dhënat e disponueshme i përkasin periudhës deri në nëntor 2010. Ky monitorim do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2011.

- ***Tregu i shitjes së bulmetit.***

Gjatë fundit të muajit gusht 2010 disa ofrues të produkteve të bulmetit rriten çmimin e produkteve qumësht dhe kos, kryesisht të ambalazhit qumësht në shishe plastike 1.5 litër dhe kos 400 gr. Sektori i Analizës dhe Studimeve ndërmori një monitorim për këto dy produkte ku në fund të monitorimit u konstatua se rritja e çmimeve të produkteve qumësht dhe kos nga disa ofrues të këtyre produkteve është pasojë e vendosjes së akcizës për ambalazhet plastike (100 lekë/kg) dhe nuk rezultuan sinjale të ndonjë shkeljeje të mundshme të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës".

- **Hartimi i databazës për sektorët e ekonomisë**

Një nga prioritetet e vitit 2010 ishte ndërtimi i databazës me të dhënat për sektorët e ekonomisë. Qëllimi i këtij projekti do të ishte grumbullimi i të dhënave të mjaftueshme me qëllim përcaktimin e strukturës së tregjeve sipas sektorëve kryesore të ekonomisë. Ky projekt u parapri nga hartimi i metodologjisë, i cili parashikonte hapat konkrete që do të ndiqeshin si, përcaktimi i sektorëve të ekonomisë, përcaktimi i sektorëve prioritarë, përcaktimi i konkurrenteve sipas çdo sektori, përcaktimi i burimeve të informacionit, përcaktimi i mënyrës së përpunimit të informacionit dhe të treguesve baze të vlerësimit të konkurrencës. Por ndërtimi i databazës ende nuk ka përfunduar për shkak të mungesës së informacionit dhe mosplotësimit të kërkesës drejtuar DPT për sigurimin e të dhënave të nevojshme. Gjithësesi, Sektori i Analizës shfrytëzon të gjitha mënyrat për të akumuluar të dhëna dhe plotësimin e databazës.

II. Avokacia e konkurrencës

Advokacia e konkurrencës ka vazhduar të luajë një rol qendror në aktivitetin e Autoritetin e Konkurrencës edhe gjatë vitit 2010 dhe është fokusuar në bërjen publike të elementëve që kanë shërbyer si bazë për marrjen e vendimeve, njohjen e publikut të gjerë dhe ndërmarrjeve me rregullat e konkurrencës dhe përfitimet që ato sjellin për konsumatorin final.

Gjatë vitit të kaluar Autoriteti i Konkurrencës ndërmori një sërë veprimtarish për rritjen e advokacisë së konkurrencës nëpërmjet përdorimit të një sërë instrumentash si: dhënia e rekomandimeve për aktet ligjore dhe nënligjore që prekin konkurrencën në tregje; organizimin e tryezave konsultative me institucionet dhe entet rregullatorë; administrimin dhe përgjigjen ndaj ankesave etj.

Eshtë një zhvillim pozitiv për rritjen e advokatisë së konkurrencës edhe rritja e numrit të rasteve kur institucionet i drejtohen Autoritetit të Konkurrencës për shprehje opinionin në lidhje me draft aktet që kanë ndikim mbi konkurrencën në treg, por gjithsesi në jo pak raste entet rregullatorë dhe institucione e tjera qëndrore dhe vendore nuk respektojnë detyrimet që rrjedhin nga nenet 69 dhe 70 të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Këto aktivitete çojnë në një njohje më të mirë të rregullave të konkurrencës si dhe në sqarimin e disa aspekteve të konkurrencës për aktivitetin e ndërmarrjeve.

II.1. Vlerësimi i projekt-akteve juridike të institucioneve të tjera

Shtylla e katërt e zbatimit të ligjit dhe një nga instrumentat ligjor për realizimin e Avokacisë së Konkurrencës është edhe dhënia e vlerësimeve dhe opinioneve të Komisionit të Konkurrencës ndaj draft apo akteve normative të kërkuara nga institucionet e tjera rregullatore dhe /ose publike. Gjithsesi në këtë kuadër do të veçonim dhënien e vlerësimeve për aktet vijuese si ndër më të rëndësishmet:

- Projekt-Ligji “Për kundërvajtjet administrative”; Lidhur me këtë projektligj Autoriteti i Konkurrencës vlerësoi zgjidhjen e çështjes së arkëtimit të gjobave administrative nëpërmjet instrumentave ligjorë dhe u shpreh për disa ndryshime që duhet të pasqyroheshin në akt lidhur me procedurën e ankimit në gjykatë e cila nuk duhet të pezullonte zbatimin e aktit të lëshuar nga Komisioni i Konkurrencës.
- Vlerësimi ligjor i “Marrëveshjes se koncesionit te Aeroporti te Rinasit”. Autoriteti i Konkurrencës pas kërkesës së Ministrisë së Transportit nëse kontrata koncesionare e aeroportit të Rinasit sillte kufizime te konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, u shpreh se dhënia e të drejtës ekskluzive për të operuar si aeroporti i vetëm për fluturime ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë përbën barrierë hyrjeje në treg duke penguar hyrjen e konkurrentëve të rinj në tregun e fluturimeve ndërkombëtare (kargo dhe pasagjerë). Komisioni i Konkurrencës propozoi rishikimin e marrëveshjes në bazë të tregut përkatës gjeografik (duke kufizuar territorin ekskluziv në një rreze jo më shumë se 100 km nga aeroporti i Rinasit) të përcaktuar edhe në rastet e shqyrtuara nga Komisioni Europian.

- Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 8530, datë 23.09.1999 “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Nga vlerësimi ligjor i Autoritetit të Konkurrencës rezultoi se akti nuk binte në kundërshtim me Ligjin “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
- “Mbi projekt-marrëveshjen për mbrojtjen dhe nxitjen e investimeve me Kanadanë”. Nga vlerësimi ligjor i Autoritetit të Konkurrencës rezultoi se draft-marrëveshja nuk binte në kundërshtim me Ligjin “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
- Projekt-vendimi “Për përcaktimin e Autoritetit Kontraktues, për dhënien me konçesion të Rrjetit Kombëtar me Brez të Gjerë, (REKAB) në Republikën e Shqipërisë” (National Broadband Network)”. Nga vlerësimi ligjor i Autoritetit të Konkurrencës rezultoi se akti nuk binte në kundërshtim me Ligjin “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

II.2. Rekomandime nga monitorimet dhe hetimet në treg

Një instrument tjetër i rëndësishëm dhe që përbën një vlerë të shtuar të monitorimeve dhe hetimeve në tregje të ndryshme që ndërmerren nga autoriteti janë edhe rekomandimet që u ka dhënë Autoriteti i Konkurrencës, rast pas rasti, enteve rregullatore apo institucioneve të qeverisjes qendrore.

Shtojca nr 3 “Matrica e vlerësimeve dhe rekomandimeve të Autoritetit të Konkurrencës për vitin” paraqet në mënyrë krahasimore rekomandimet e Komisionit të Konkurrencës dhe shkallën e marrjes në konsideratë të tyre nga institucionet respektive. Konkretisht këto vendime janë sa më poshtë:

1. Me Vendimin nr. 143, dt. 15.03.2010 “Mbi disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun primar dhe sekondar të bonove të thesarit”, Komisioni i Konkurrencës ka dhënë rekomandime për Bankën e Shqipërisë, Ministrinë e Financave dhe Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare me qëllim rritjen e konkurrencës në tregun primar dhe sekondar të bonove të thesarit;
2. Me Vendimin Nr. 144, datë 23.03.2010 “Rekomandim për Entin Rregullator të Energjisë për liçensimin e dy shoqërive “Cable System” sh.p.k dhe “400KV” sh.p.k”, Komisioni i Konkurrencës i ka rekomanduar Entit Rregullator të Energjisë Elektrike të pajisë me liçencë për tregtimin e energjisë elektrike shoqëritë “Cable Sistem” sh.p.k dhe “400KV” sh.p.k;
3. Me Vendimin Nr. 158, datë 12.11.2010 “Për disa rekomandime për parandalimin e marrëveshjeve në oferta në prokurimet publike”, Komisioni i Konkurrencës i ka rekomanduar Agjencisë së Prokurimit Publik, Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit të Shqipërisë, mendimin e Ligjit “Për Prokurimin Publik” dhe pasurimin e kuadrit ligjor të prokurimeve me akte nënligjore me qëllim parandalimin e marrëveshjeve në oferta në prokurimet publike;

4. Me Vendimin Nr. 159, datë 19.11. 2010 “Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e energjisë elektrike”, Komisioni i Konkurrencës ka dhënë disa rekomandime për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Entit Rregullator të Energjisë Elektrike me qëllim rritjen e konkurrencës në tregun e energjisë elektrike;

5. Me Vendimin Nr. 161, datë 02.12.2010 “Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në sektorin e komunikimeve elektronike në tregun e teknologjisë me bazë të gjerë” 3G”, Komisioni i Konkurrencës i ka rekomanduar Ministrisë së Inovacionit dhe Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit liberalizimin e tregut të shërbimit të 3G, si dhe Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare rregullimin e tregut të shërbimit të teknologjisë me brez të gjerë mbi baza të metodologjive transparente dhe të rregullojë tarifat e shërbimit të orientuara drejt kostos.

Me anë të tyre është synuar jo vetëm përmbushja e detyrave funksionale të Autoritetit, që rrjedh nga neni 69 e Ligjit, por edhe përmirësimi i gjendjes së konkurrencës në tregjet për të cilat janë dhënë këto rekomandime, në mënyrë që konsumatori fundor të prekë ekonomikisht efektet e konkurrencës në tregje.

Advokacia e Konkurrencës në Marrëveshjet në Oferta (bid rigging)

Autoritetet e Konkurrencës në vendet e OECD-së dhe jashtë saj kanë arritur një konsensus se nëse kartelet janë format më antikonkurrese të sjelljes në treg, praktikat e sjelljes së bashkërenduar janë praktikat më të shpeshta të karteleve dhe që hasen në thuajse të gjitha vendet antare ose jo të OECD-së.

Komisioni i Konkurrencës pas procedurave hetimore në rastin e marrëveshjes së ndaluar në tregun e prokurimeve publike të makinave të reja dhe pas shqyrtimit të praktikave të vendeve të OECD-së vendosi të bashkëpunojë me institucionet e ngarkuara në prokurimet publike me qëllim zbulimin dhe parandalimin e marrëveshjeve të ndaluara në prokurimet publike.

Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit Nr.158, datë 12.11.2010 “Për disa rekomandime për parandalimin e marrëveshjeve në oferta në Prokurimet Publike” vendosi t’i rekomandojë Agjencisë së Prokurimit Publik, Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit të Shqipërisë, për amendimin e Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, në nenin 13, pika 3, sipas se cilës APP përjashton një operator ekonomik nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit për një periudhë 1-3 vjet për rastet e propozuara sipas germave a, b, c, ç të kësaj pike, ku të shtohet, germa d, me përmbajtje si vijon: “d) Për rastet kur me Vendim të Komisionit të Konkurrencës është zbuluar ekzistenca e një marrëveshjeje në oferta midis operatoreve ekonomike pjesëmarrës në procedurat e prokurimeve”.

Në kuadrin ligjor të fushës së Prokurimeve Publike duhet të parashikohen procedurat që mbulojnë raste kur Autoriteteve Kontraktore u lind përgjegjësia për të njoftuar Autoritetin e Konkurrencës, në rastet kur gjatë projektimit dhe/ose zhvillimit të procedurave të

prokurimit vihen re shenja të marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike. Në bashkëpunim me Autoritetin e Konkurrencës të formulohet një kre i veçantë në VKM nr. 1 “Për rregullat e prokurimit publik” (ose në çfarëdo lloj akti tjetër ligjor që konsiderohet i përshtatshëm) në të cilin të përcaktohen rastet e mësipërme.

Komisioni i rekomandoi **Agjencisë së Prokurimit Publik që të përfshijë** në dokumentet standarde të tenderit Çertifikatën për Ofertë të Pavarur si dhe ofroi bashkëpunimin e Autoritetit të Konkurrencës për trajnimin e zyrtarëve të prokurimit mbi rëndësinë e zbulimit dhe parandalimit të marrëveshjeve në oferta, mënyrat dhe mjetet e luftimit të këtyre marrëveshjeve me pasoja mjaft të rënda për konkurrencën, taksapaguesit dhe vetë buxhetin e shtetit.

Pas nënshkrimit të memorandumit të bashkëpunimit mes Autoritetit të Konkurrencës dhe Agjencisë së Prokurimit Publik, është parashikuar zbatimi i një plan veprimi me qëllim rritjen e konkurrencës dhe efikasitetit të prokurimeve publike; parandalimin e marrëveshjeve në oferta në prokurimet publike; ndërgjegjësimin e bizneseve dhe publikut për luftimin e marrëveshjeve në oferta; ndërgjegjësimin e pjesëmarrësve në tenderë për pasojat e marrëveshjeve në oferta; zbulimin dhe raportimin e shkeljeve të rasteve të mundshme në procedurat e prokurimit.

Në kuadër të projektit të Binjakëzimit financiar nga Bashkimi Evropian, ekspertët e BE-së do të trajtojnë stafin e Autoritetit të Konkurrencës nga ana e ekspertëve me praktikantë e vendeve të Bashkimit Evropian në rastet e hetimit të praktikave antikonkurrese në prokurime publike.

Gjithashtu të gjithë nënpunësit e ngarkuar me prokurimet publike do të trajtohen për të evidentuar shenjat e mundshme të marrëveshjeve në prokurimet publike si dhe do të njoftojnë Autoritetin e Konkurrencës për rastet e dyshuara.

Një set publikimesh mbi evidentimin e marrëveshjeve të ndaluara në prokurimet publike dhe mënyrat e bashkëpunimit me Autoritetin e Konkurrencës është përgatitur dhe do të publikohet nga projekti i Asistencës Teknike të Bashkimit Evropian.

Rezultatet e pritshme të këtij bashkëpunimi lidhen me rritjen e ankesave nga ofertuesit ose bizneset e tjera rreth marrëveshjeve të ndaluara dhe hapja e hetimit; zbulimin dhe raportimin e shkeljeve të rasteve të mundshme në procedurat e prokurimit për bashkëpunimet potenciale; rritja e konkurrencës dhe efikasitetit të prokurimeve publike; sinjalizimi në kohë reale i Autoritetit të Konkurrencës lidhur me rastet e dyshuara për marrëveshje në oferta si dhe ndërgjegjësimi i bizneseve dhe publikut për luftimin e marrëveshjeve në oferta.

II.3 Reforma rregullatore (RIA)

Autoriteti i Konkurrencës, në Janarin e vitit 2008 hartoi “Udhëzuesin për vlerësimin e akteve normative” nga pikëpamja e së drejtës së konkurrencës me synimin e rritjes së

forcës zbatuese të nenit 69, i cili i detyron të gjitha institucionet publike të marrin vlerësimin e Autoritetit të Konkurrencës para miratimit të akteve normative. Sistematikisht është punuar që të rritet ndjeshmëria e këtyre institucioneve.

Autoriteti gjatë vitit 2010 është vënë në dijeni dhe është paraqitur si palë interesi për Vlerësimin e Ndikimit Rregullator(RIA), i cili ka si qëllim të ndihmojë politikbërësit dhe zyrtarët e tjerë të shtetit në hartimin e projektligjeve duke siguruar udhëzime praktike dhe që do të shoqërojë çdo akt që do shqyrtohet nga Këshilli I Ministrave.

Autoriteti i Konkurrencës ka propozuar një shtojcë të veçantë për ndikimet e akteve në konkurrencës që nënkupton që hartuesit e akteve duhet t'i përgjigjen pyetësorit lidhur me ndikimin që do të kenë aktet në treg kryesisht në kufizimin e numrit të ofertuesve, dhënien e të drejtave të veçanta apo ekskluzive, impaktin në treg dhe kufizime të tjera që mund të sjellë akti në konkurrencën e lirë dhe efektive në treg.

II.4 Bashkëpunimi me entet rregullatore dhe institucionet e tjera

Autoriteti i Konkurrencës ka bashkëpunuar ngushtësisht me entet rregullatore dhe institucionet e tjera të lidhura me rregullimin dhe/ose funksionimin e tregjeve specifike. Kryesisht vlerësimet e kuadrit ligjor dhe rregullator dhe dhënia e rekomandimeve përkatëse në rastet e kufizimit të konkurrencës së lirë dhe efektive në treg janë ndërmarra me nismën e vetë Autoritetit të Konkurrencës.

Autoriteti i Konkurrencës gjatë ushtrimit të aktiviteteve të tij bashkëpunon me institucione të ndryshme publike, në lidhje me çështje që synojnë mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg. Bazuar në Ligjin nr 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" organet e administratës qendrore dhe entet rregullatorë kanë detyrimin për të shkëmbyer informacion dhe të dhëna në lidhje me qëllimin për të cilin kërkohen.

Një rëndësi e veçantë i është kushtuar bashkëpunimit me institucionet rregullatorë kompetente në fusha të caktuara të ashtuquajtur sektorë rregullatorë. Autoriteti i Konkurrencës ka dhënë kontributin e vet edhe gjatë këtij viti në sektorë dhe fusha të ndryshme të ekonomisë të tilla si energjia, telekomunikacioni, shërbimet postare, shërbimet financiare etj.

Duke e konsideruar të rëndësishëm këtë bashkëpunim me institucionet qendrore, vendore dhe përfaqësues të biznesit, Autoriteti i Konkurrencës, ka nënshkruar memorandume mirëkuptimi të tilla si Memorandumi me Bordin e Mbikëqyrjes Publike si dhe në kuadër të një konsolidimi të mëtejshëm të marrëdhënieve me rregullatorët pritet të nënshkruhet së afërmi memorandumi me Entin Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura.

II.5 Ekzekutimi i vendimeve të Komisionit të Konkurrencës

Me miratimin e Ligjit Nr. 10 317 datë 16.09.2010 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9121 datë 28. 07. 2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", (të ndryshuar)", u zgjidh dhe ngërçi juridik i ekzekutimit të vendimeve të Komisionit të Konkurrencës. Sipas nenit 80 të Ligjit të ndryshuar, "Gjoha e vënë nga Autoriteti i Konkurrencës është titull ekzekutiv dhe ekzekutohet sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Civile".

Menjëherë pas hyrjes në fuqi të Ligjit, Autoriteti i Konkurrencës ndoqi procedurat gjyqësore për zbardhjen e vendimeve për ekzekutimin e gjobave të vendosura nga Komisioni i Konkurrencës në rastet kur vendimet kishin marrë formë të prerë.

Sipas Kodit të Procedurës Civile, organi i ngarkuar për mbledhjen e tyre është shërbimi përbarimor. Deri në muajin Janar 2011 ka dalë vendimi i Gjykatës së Rrethit Tiranë për lëshimin e urdhrat të ekzekutimit për 6 vendime të Komisionit të Konkurrencës, të cilat janë të formës së prerë dhe janë dërguar pranë Zyrës së Përbarimit për ndjekjen e procedurës. Konkretisht janë lëshuar urdhrat e ekzekutimit dhe kanë filluar procedurat nga Zyra Përbarimore për 20 % të shumës totale të gjobave të vendosura (ose për 3 vendime të Komisionit të Konkurrencës dhe janë në procedurë përbarimore edhe 23 % të tjera të shumës totale të gjobave të vendosura.


III. Ankesat dhe kultura e konkurrencës

III.1 Ankesat - instrument i rëndësishëm

Autoriteti i Konkurrencës i konsideron ankesat për problematikat që shfaqen për nivelin e konkurrencës dhe funksionimin e tregjeve si një instrument shumë të rëndësishëm për rritjen e forcës zbatuese të ligjit dhe për forcimin e advokacisë së politikës së konkurrencës. Rritja e nivelit të ankesave shpreh rritjen e kulturës ndaj konkurrencës.


Gjatë vitit 2010 Autoriteti i Konkurrencës ka shqyrtuar disa ankesa të ndërmarrjeve që operojnë në tregje të ndryshme. Me ndryshimet në Rregulloren e Funksionimit të Brendshëm të Autoritetit të Konkurrencës është bërë e mundur trajtimi i ankesave në një periudhë sa më të shkurtër kohe ku brenda 5 ditësh Sekretariati raporton në Komisionin mbi objektin e ankesës dhe propozimet për zgjidhje dhe ankimuesi njoftohet jo më vonë se 15 ditë nga paraqitja e ankesës. Kjo procedurë ka rritur efikasitetin e administratës në trajtimin e rasteve dhe nga ana tjetër ka çuar në hapjen e një sërë procedurash monitorimi dhe/ose hetimi në rastet kur ankesa lidhej me objektin e Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Sa vijon në grafikun e parë është paraqitur rritja e ndjeshme e numrit të ankesave të ardhura pranë Autoritetit të Konkurrencës gjatë viteve të fundit nga 1 gjatë vitit 2008, në 7 për 2009 dhe në 11 ankesa gjatë vitit 2010.



Grafik Nr. 1: Numri i ankesave në vite

Ankesat e ardhura gjatë vitit të kaluar kanë qenë 4 të lidhura me objektin e Ligjit dhe 7 që nuk kanë patur lidhje me Ligjin “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Por edhe në këtë rast Autoriteti i Konkurrencës i ka adresuar ankesat pranë institucioneve përkatëse dhe ka kërkuar informacion në mënyrë të vazhdueshme mbi zgjidhjen e tyre.



Grafik Nr. 2: Ankesa që kanë lidhje me objektin e ligjit dhe që nuk kanë lidhje me objektin e ligjit

Ankesat kryesisht janë në sektorin e komunikimeve elektronike ku operatorët e klasifikuar si alternativë ankohen për abuzime të mundshme me pozitën dominuese të kompanive të mëdha të telefonisë fikse dhe asaj të lëvizshme. Por gjatë vitit 2010 ka patur një veçori pasi për herë të parë janë ankuar operatorë me fuqi të ndjeshme në treg ndaj konkurrentëve të tyre që janë gjithashtu me fuqi të ndjeshme në treg. Theksojmë se Autoriteti i Konkurrencës bashkëpunon ngushtë me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare për zgjidhjen e këtyre ankesave që përgjithësisht janë objekt i ligjit “Për komunikimet elektronike”.

- **Trajtimi i ankesës dhe monitorimi i tregut të tregimit të kartonit jeshil**

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është paraqitur një ankesë në formë elektronike nga një person në lidhje me mënyrën e tregimit të Certifikatës Ndërkombëtare të Sigurimit (Kartoni Jeshil). Ankimuesi pretendonte se tregu i tregimit të këtij shërbimi, (Certifikata Ndërkombëtare e Sigurimit) është “monopolizuar” nga një broker i vetëm dhe shitet me çmime të padrejta, duke kufizuar në këtë mënyrë konkurrencën në treg dhe duke dëmtuar konsumatorin, atëherë Autoriteti i Konkurrencës në zbatim të nenit 28, (pika a) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, realizoi një monitorim të çmimit dhe të mënyrës së tregimit të “Kartonit Jeshil”, si dhe realizoi një takim me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, si dhe një cikël intervistimesh me përfaqësues të shoqërive që tregtonin Kartonin Jeshil.

Në përfundim të këtij monitorimi u konstatua se aktet ligjore: Ligji Nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, si dhe rregullorja “Për primet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, miratuar me vendimin e bordit nr. 75, që rregullojnë tregun e ofrimit të këtij produkti, vendosnin parametra të gjera të zbatimit të konkurrencës, duke mos cënuar Ligjin Nr.9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Tregtimi i Kartonit Jeshil kryhej nëpërmjet regjistrit elektronik on-line të shitjeve, nga përfaqësues të autorizuar nga shoqëritë e sigurimit dhe ishte e pamundur shitja e këtij produkti nga agjentë të tjerë të palicensuar, për vetë natyrën e funksionimit të këtij sistemi i cili kontrollohej on line nga AMF.

Tregtimi i këtij produkti me një çmim të fiksuar prej 40 Euro vinte si pasojë e zbatimit të Urdhrit të Ministrit të Financës Nr. 1, datë 3.01.1996 “Për miratimin e primeve për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta jashtë” (i ndryshuar).

- **Shqyrtimi i ankesës së shoqërive të ruajtjes dhe sigurisë fizike**

Pranë Autoritetit të Konkurrencës janë paraqitur dy ankesa nga ndërmarrjet e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike për hartim të kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim të pa bazuar në ligjet në Republikën e Shqipërisë nga Autoriteti kontraktor” dhe “Kërkesë Autoritetit të Konkurrencës të ndërhyje pranë APP-së për të bërë të mundur konkurrimin sa më të drejtë, ligjore dhe jo diskriminuese në procedurat e prokurimit publik”.

Për sa më sipër u realizua vlerësimi ligjor i ankesave nga u arrit në përfundimin se Agjencia e Prokurimit Publik është institucioni kompetent për shqyrtimin administrativ të ankesave me qëllim evidentimin e shkeljeve të ligjit të prokurimeve dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij dhe marrjen e masave përkatëse sipas ligjit.

Duke marrë parasysh faktin se Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 114, dt. 26.05.2009 “Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në prokurimin publik të Shërbimit të Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike”, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të ankesave të bëra nga disa SHRSF, ka bërë disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në prokurimin publik të Shërbimit të Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike drejtuar Autoritetit Kontraktor përkatës dhe APP-së, mendojmë që zgjidhja e administrative e ankesave të paraqitura duhet të kërkohet të procedohet në vazhdim nga organet kompetente sipas ligjit të prokurimeve publike.

- **Ankesa e shoqërisë Klar ndaj Conad**

Ndërmarrja Klar Shpk ka pretendime për mosrespektim të marrëveshjes së eskuzivitetit dhe shitje nën çmimin ekskluziv të kafesë Segafredo 2x250gr. nga ndërmarrja Conad Shqipëri shpk.

Pas monitorimit të tregut të shitjes së këtij produkti, vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur nga ndërmarrjet Klar shpk dhe Conad Shqipëri shpk, grupi i punës arriti në konkluzionin se ndërmarrja Conad Shqipëri shpk, nuk ka shkelur të drejtën ekskluzive që ndërmarrja Klar ka me kompaninë Segafredo Zanetti, pasi ndërmarrja Conad Shqipëri shpk është importuese dhe tregtuese e këtij produkti vetëm në rritjen e dyqaneve të tij. Ndërmarrja Conad Shqipëri shpk nuk ka shitur produkte me çmime nën koston e tij duke mbyllur monitorimin rreth kësaj anekese.

- **Ankesa e ndërmarrjes ‘Mozzarella Italia’**

Gjatë muajit korrik të këtij viti ndërmarrja Mozzarella Italia ka paraqitur ankesën e saj pranë Autoritetit të Konkurrencës lidhur me sjelljen e ndërmarrjes “FERLAT” Sh.p.k e cila operon në tregun e prodhimeve dhe tregtimit të produkteve të qumështit. Pas

shqyrtimit të kësaj ankese nga Sekretariati u konkludua se nuk ka elemente të kufizimit apo shtrembërimit të konkurrencës në këtë treg.

- **Ankesa e ndërmarrjes Bell-air**

Ndërmarrja Bell-air ka paraqitur një ankesë pranë Autoritetit të Konkurrencës për kompaninë ajrore Star Airways lidhur me reklamën mashtruese. Pas shqyrtimit të ankesës nga Sekretariati u konkludua se kjo praktikë nuk është objekt i ligjit 'Për mbrojtjen e konkurrencës' por është objekt i Ligjit 'Për mbrojtjen e konsumatorit', i cili rregullon praktikat e padrejta tregtare, ku bëjnë pjesë dhe reklamat mashtruese ose publicitetin ç'orientues.

- **Ankesa në tregun e komunikimeve elektronike**

Gjatë këtij viti pranë Autoritetit të Konkurrencës kanë ardhur disa ankesa nga operatorët në tregun e komunikimeve elektronike. Në qershor operatori "Albanian Carrier Telecommunications" sh.p.k ka paraqitur ankesën e saj për operatorët me fuqi të ndjeshme në treg. Sipas 'Albanian Carrier Telecommunications' sh.p.k këta operatorë nuk zbatonin marrëveshjen e interkoneksionit. Pas shqyrtimit të kësaj ankese nga Sekretariati u konkludua se kjo ankesë nuk bie në fushën e veprimtarisë së ligjit 'Për mbrojtjen e konkurrencës'.

Në shtator operatori Altelekom paraqiti ankesën e tij për operatorin AMC, i cili kryen bllokimin e qarqeve ndërkombëtare të interkoneksionit dhe bllokimin e një sërë trukesh për trafikun e operatorëve alternative. Pas shqyrtimit të ankesës nga Sekretariati u konkludua se kjo ankesë ka të bëjë me moszbatimin e marrëveshjes së interkonjeksionit nga njëra palë, pra nuk është kompetence e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës, por është Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare institucioni përgjegjës për zgjidhjen e këtyre problematikave.

- **Shqyrtimi i Ankesës së Universitetit "Justiniani" lidhur me praktikat e padrejta tregtare të Universitetit European te Tiranës**

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar ankesa e Universitetit "Justiniani" nëpërmjet së cilës kjo shoqëri pretendon se: "Universiteti European i Tiranës ka vënë në transmetim prej disa ditësh një spot publicitar në të cilin thuhet se UET-ja ofron studime të doktoraturës në disa degë, gjë që sipas Universitetit "Justiniani" është e pa vërtetë.

Transmetimi i këtij spoti nuk pasqyron të vërtetën dhe mashtron konsumatorin dhe opinionin publik. Pas shqyrtimit të kësaj ankese rezultoi se pretendimi i Universitetit "Justiniani" qëndron në kryerjen nga ana e Universitetit European të Tiranës të praktikave të padrejta tregtare çorientuese (konkretisht publicitetet çorientuese), praktika këto të ndaluara të cilat rregullohen dhe sanksionohen sipas Ligjit nr. 9902, dt. 17.4.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve".

Përsa më sipër rasti i paraqitur, nuk përbënte objekt shqyrtimi për Autoritetin e Konkurrencës, bazuar në ligjin "Për mbrojtjen e konkurrencës".

- **Shqyrtimi i ankesës së paraqitur nga Universiteti “Pavarësia” Vlorë**

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është paraqitur ankesa e Universitetit “Pavarësia” Vlorë me anë të së cilës kjo ndërmarrje pretendon se: Prej rreth një muaji i vetëquajtur Universitet “Reald” në Vlorë, dezinformon publikun me anë të reklamave mediatike në TV lokal dhe rajonal të Jugut të Shqipërisë si dhe me anë të fletëpalosjeve publicitare të shpërndara prej tij, duke pretenduar ushtrimin e veprimtarisë ligjore si IAL me qendër në Vlorë, në të dy ciklet e studimit duke përfshirë dhe Master Profesional dhe Shkencor.

Pas shqyrtimit të rastit rezultoi se pretendimi i Universitetit “Pavarësia” Vlorë” qëndron në kryerjen nga ana e Universitetit “Reald” Vlorë të praktikave të padrejta tregtare çorientuese (konkretisht publicitetet çorientuese), praktika këto të ndaluara të cilat rregullohen dhe sanksionohen sipas Ligjit Nr. 9902 datë 17. 04. 2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” dhe nuk përbën objekt shqyrtimi për Autoritetin e Konkurrencës, bazuar në Ligjin Nr. 9121 datë 28. 07. 2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

- **Shqyrtimi i ankesës së ndërmarrjes “Agjencia 100% Shqip”**

Pranë Autoritetit të Konkurrencës ndërmarrja “Agjencia 100% Shqip” ka bërë ankim lidhur me: “Moszbatimin e kriterëve ligjore në trajtimin e kursanteve të Autoshtollës Vitrina nga Drejtoria Rajonale e Transportit Tiranë”. Në ankesën e saj, kjo ndërmarrje pretendon se i janë krijuar pengesa dhe krijuar probleme nga ana e Drejtorisë Rajonale të Transportit Tiranë të cilat kanë konsistuar në: zvarritje pa fund të përpunimit të dokumentacionit të kursantëve dhe klientëve të saj, duke prishur imazhin e mirë që ka; ushtrim presioni ndaj klientëve vetëm për faktin se ato frekuentojnë autoshtollën “Vitrina”; favorizohen autoshtollat e tjera; është bllokuar puna e kësaj Autoshtolle për periudhën Prill-Qershor 2009 pa asnjë bazë ligjore; Sistemi i mësimdhënies nuk i përshtatet standardeve përëndimore; Zvarritje të problemit të nxjerrjes së kartonit për leje drejtimi automjesh; etj.

Nën këndvështrimin e ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” kjo ankesë nuk përbënte objekt shqyrtimi nga Autoriteti i Konkurrencës, por gjithsesi Autoriteti monitoroi pretendimet e ngritura në ankesë. Nga analiza e konkurrencës rezultoi se: Tregu i Autoshtollave është një treg që funksionon në bazë të ligjit Nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, dhe Ligjit Nr 8308, dt 18.03.1998 “Për transportet rrugore” si dhe akteve nënligjore në zbatim.

Ky është një treg plotësisht i liberalizuar dhe i rregulluar. Nga analiza rezultoi se në këtë profesion nuk ka barriera në hyrje. Në qytetin e Tiranës ushtrojnë aktivitet 83 autoshtolla. Për sa i përket tarifave nuk ka çmime tavan ose dysheme të përcaktuara, ato negociohen lirshëm midis klientit dhe administratorit të ndërmarrjes. Edhe në këtë rast, në përfundim të monitorimit, rezultoi se nuk ka evidenca që tregojnë për shkelje të konkurrencës në treg ose sjellje apo elementë që bien në kundërshtim me Ligjin nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

III.2 Rritja e kulturës së konkurrencës

Gjatë vitit 2010, Autoriteti ka bërë përpjekje për implementimin e një politike aktive për rritjen e kulturës së konkurrencës, e cila vazhdon të mbetet e ulët me gjithë përmirësimet e dukshme. Rritja e kulturës së konkurrencës përbën një nga sfidat më të rëndësishme të Autoritetit të Konkurrencës .

- **Ndërgjegjësimi i bizneseve dhe institucioneve publike**

Rritja e nivelit të ndërgjegjëimit të biznesit, konsumatorëve, institucioneve publike, sistemit gjyqësor dhe publikut, lidhur me rëndësinë dhe rolin e politikës së konkurrencës, është realizuar nëpërmjet një komunikimi të gjerë publik, në përgjithësi ashtu edhe me anë të seancave dëgjimore e konsultative me përfaqësues të bizneseve të ndryshme e institucioneve publike. Këto seanca kanë shkuar përtej diskutimit të çështjeve konkrete duke u ndalur në filozofinë e promovimit dhe të mbrojtjes së konkurrencës dhe rëndësinë e zbatimit të ligjit të konkurrencës në tërë në veprimtarinë e bizneseve, si dhe të mbajtjes parasysh të këtij ligji gjatë veprimtarisë së institucioneve të ndryshme publike.

Komunikimi me aktorët e tregut dhe me publikun e gjerë përveç rritjes së kulturës së konkurrencës, ka siguruar transparencën e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës. Për arritjen e transparencës së plotë, Autoriteti ka organizuar seanca dëgjimore e konsultative me palët nën hetim e institucione të ndryshme publike për të siguruar mirëfunksionimin e tregut në tërësi dhe jo vetëm mbi hetimet e kryera. Në lidhje me procedurat e përqendrimit të ndërmarrjeve, Autoriteti ka ftuar të gjithë palët e interesuara për të dhënë opinionin e tyre.

Vendimet e Autoritetit të Konkurrencës janë publikuar në faqen e internetit në kohë reale duke siguruar në këtë mënyrë kontrollin publik dhe rritjen e përgjegjshmërisë së Autoritetit të Konkurrencës dhe veprimtarisë së tij. Bashkëpunimi me publikun, bizneset dhe institucionet e tjera publike është i një rëndësie të veçantë për zbatimin e plotë të politikës së konkurrencës në Shqipëri.

Në këtë kuadër, veçanërisht i rëndësishëm është marrja e mendimit të biznesit mbi politikën e konkurrencës në Shqipëri dhe mbi veprimtarinë konkrete të Autoritetit të Konkurrencës. Për këtë arsye, ky institucion ka draftuar një pyetësor, i cili në bashkëpunim me organizatat e biznesit dhe dhomat e tregtisë do t'i shpërndahet ndërmarrjeve të ndryshme për të marrë në mënyrë të drejtpërdrejtë mendimin e tyre mbi veprimtarinë e Autoritetit dhe mbi përmirësimet e mundshme të punës.

- **Komunikimi me publikun dhe mediat**

Autoriteti i Konkurrencës i ka kushtuar një rëndësi të veçantë ndërgjegjëimit dhe rritjes së kulturës së konkurrencës së publikut të gjerë, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe me anë të mediave. Autoriteti ka vazhduar të promovojë konkurrencën e lirë dhe efektive me anë të publikimeve të ndryshme dhe faqes së internetit www.caa.gov.al. Kjo faqe është kthyer në një nga mjetet më të rëndësishme të komunikimit të drejtpërdrejtë me publikun, i cili mund të gjejë në të si informacion të përgjithshëm mbi çështje të

konkurrencës së lirë dhe efektive, organizimin dhe legjislacionin, por edhe informacion të përditësuar mbi veprimtarinë konkrete të Autoritetit, hetimet dhe vendimet e marra.

Autoriteti i Konkurrencës ka vazhdat të shpërndajë te palët e interesuara botimet informuese mbi politikën e konkurrencës si Politika e Konkurrencës, Broshurën “E drejta e konkurrencës dhe mbrojtja e konsumatorit”, raportet vjetore, buletinet e vendimeve etj. Autoriteti i Konkurrencës ka bashkëpunuar edhe me institucionet e arsimit të lartë duke krijuar mundësinë për kryerje të praktikave mësimore për studentët.

Veçanërisht i rëndësishëm ka qenë komunikimi i vazhdueshëm me publikun me anë të mediave të shkruara dhe audio-vizive, e cila ka treguar një interes të madh në pasqyrimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës. Komunikimi me mediat është realizuar nëpërmjet njoftimeve për shtyp, intervistave, konferencave të shtypit, pjesëmarrjes në programe të ndryshme televizive etj.

IV. Integrimi europian në fushën e konkurrencës

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, e cila hyri në fuqi më 1 Prill 2009, pas ratifikimit të saj nga 25 vendet anëtare të BE-së, është instrumenti i cili do të mundësojë integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit parashikon adoptimin e *acquis communautaire* në sistemin juridik të brendshëm të Shqipërisë. Qëllimi i përafritit të legjislacionit është krijimi i një kuadri ligjor dhe institucional, që do të lejojë tregun shqiptar të integrohet në tregun europian.

Për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë ka miratuar Planin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Detyrimet që rrjedhin nga MSA për Autoritetin e Konkurrencës lidhen me përafritimin e legjislacionit shqiptar me atë komunitar (*acquis communautaire*) në fushën e konkurrencës, si dhe mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, duke ndaluar dhe duke vendosur sanksione për ato praktika anti konkurrese të cilat shtrembërojnë, kufizojnë apo deformojnë tregun.

Bazuar në dispozitat e MSA-së, Shqipëria angazhohet të mbrojë parimet e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg nëpërmjet ndalimit të atyre marrëveshjeve të cilat prekin konkurrencën apo ndalimit të sjelljes së veprimeve abuzive në treg nga ana e një apo më shumë ndërmarrjeve të caktuara si dhe nëpërmjet kontrollit të përqendrimeve.

Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit trajton në tërësinë e tij të gjitha prioritetet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të Shqipërisë në procesin e Integritimit Evropian që parashikohen të kryhen nga ana e Autoritetit të Konkurrencës. Gjatë vitit 2010, Autoriteti i Konkurrencës ka mbajtur kontakte të rregullta me Ministrinë e Integritimit nëpërmjet hartimit të raporteve, të cilat pasqyrojnë aktivitetin e institucionit si dhe progresin e arritur në drejtim të realizimit të iniciativave ligjore, kuadrit ligjor parësor dhe dytësor në fushën e konkurrencës si dhe aktivitetet zbatuese, në përputhje me afatet e parashikuara në Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së.

Konkretisht Autoriteti i Konkurrencës (i) ka raportuar në mënyrë të vazhdueshme në lidhje me tregjet dhe sektorët në të cilët Autoriteti i Konkurrencës ka kryer hetime dhe ndërmarrjet objekt hetimi ndaj të cilave janë vendosur sanksione apo janë dhënë rekomandime të caktuara, si dhe në lidhje me nismat ligjore, aktivitetet zbatuese, monitorimet, dhe kapacitetet institucionale në lidhje me periudhën raportuese; (ii) ka rishikuar brenda afateve kohore të përcaktuara Planin Kombëtar të Zbatimit të MSA, duke pasqyruar nismat ligjore dhe aktivitetet për periudhën afatshkurter, afatmesme dhe afatgjatë; (iii) i është përgjigjur pyetjeve dhe kërkesave të ndryshme, të cilat i drejtohen Autoritetit nga Komisioni Europian brenda afateve kohore të caktuara në respektim të dispozitave ligjore dhe kuadrit ligjor dytësor; (iv) ka raportuar në kuadër të takimit të Komitetit të Stabilizim Asociimit si dhe të takimit të Nën-komitetit BE – Shqipëri “Për Tregun e Brendshëm dhe Konkurrencën” (Prill 2010) në lidhje me të gjithë aktivitetin e institucionit përgjatë një viti kalendarik; (v) ka kryer procesin e rishikimit dhe është përditësuar me legjislacionin më të fundit komunitar në fushën e konkurrencës duke i pasqyruar këto ndryshime në legjislacionin shqiptar.

IV.1 Përmirësimi i kuadrit ligjor

Kuvendi i Shqipërisë pasi shqyrtoi amendimet e Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, miratoi Ligjin Nr. 10317, datë 16.09.2010 , “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili hyri në fuqi me datë 23.10.2010, shpallur me dekretin Nr. 6696, datë 04.10.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

Amendimet e Ligjit synojnë:

(i)Garantimin në një shkallë më të lartë të zbatimit të konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, duke synuar rritjen e standardeve për një ekonomi funksionale tregu në përputhje me Acquis Communautaire;

(ii)Rritjen e avokatisë dhe ndërgjegjësimit të publikut për përfitimet nga zbatimi i konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, si një e drejtë dhe e mirë publike, të cilën askush nuk duhet ta kufizojë, shtrembërojë, ose pengojë;

(iii)Fuqizimin dhe rritjen e instrumenteve të mbikëqyrjes së tregut dhe vendosjen e masave sa më efektive për rivendosjen e konkurrencës dhe penaliteteve ndaj subjekteve që shtremberojnë konkurrencen;

(iv)Përmirësimin e procedurave ligjore dhe administrative që bashkëpunimi institucional të funksionojë në mënyrë sa më eficiente dhe në afate kohore sa më të shkurtra, në funksion të realizimit të qëllimit që ka ky projekt-ligj;

(v) Përmirësimin dhe ndryshimin e masës së sanksioneve ndëshkuese të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” duke e përputhur me legjislacionin europian.

Këto amendime kanë gjetur mbështetje tek rregulloret në zbatim të së Drejtës Europiane të Konkurrencës dhe konkretisht Rregulloren e Këshillit Europian për Përqendrimet Nr 139/2004 “Mbi kontrollin e përqendrimeve”(32004R0139); Rregulloren e Komisionit Europian Nr. 802/2004 “Në zbatim të Rregullores 139/2004” Mbi kontrollin e përqendrimeve” (32004R0802); Rregulloren 1/2003 e Këshillit Europian “Mbi implementimin e rregullave të konkurrencës sipas neneve 81 dhe 82 të Traktatit” (32003R0001), Rregullore Nr.773 CE e muajit Prill 2004 .

Në zbatim të dispozitave të amenduara të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” është përgatitur një listë e legjislacionit dytësor të AK-së, të cilat po amendohen dhe do vijojnë më tej duke pasqyruar ndryshimet e reja të ligjit të konkurrencës. Një pjesë e tyre e amenduar deri tani është përshkruar më poshtë në këtë seksion.

Filozofia e ndryshimit të ligjit ishte dyplanëshe-përafrimi me acqie dhe reflektimi i sfidave praktike të zbatimit të ligjit në ekonominë shqiptare.

- **Të drejtat ekskluzive dhe të drejtat e veçanta**

Ndërhyrja kryesore në Ligjin e konkurrencës është përfshirja në objektin e Ligjit të ndërmarrjeve të cilave ju është dhënë e drejta e ushtrimit të veprimtarisë në fushën e shërbimeve me interes ekonomik të përgjithshëm apo ato, të cilat kanë karakterin e

monopoleve të orientuara drejt sigurimit të të ardhurave, për sa kohë dhe në atë masë që në ligj dhe në fakt nuk pengohet veprimtaria e tyre.

Ndalimi i marrëveshjeve që kufizojnë konkurrencën.

Ndryshimet në nenet 4, 5, 6 të Ligjit sjellin një përafrim të plotë me nenet korresponduese të Traktateve themeluese të BE-së, si ai i Romës i 1957, i Maastrichtit 1992 dhe së fundmi i Lisbonës. Konkretisht në formën që është propozuar Neni 4 i Ligjit përafrohet plotësisht me pikat 1 dhe 2 të nenit 81 të Traktatit të Maastrichtit. Në rishikimin e ligjit është parashikuar për herë të parë përjashtimi në bllok i marrëveshjeve si dhe janë parashikuar rastet e marrëveshjeve me rëndësi të vogël (de minimis). Me ligjin e ri mund të përjashtohen nga zbatimi i pikës 1 të nenit 4 ato marrëveshje, të cilat nuk e kufizojnë ndjeshëm konkurrencën në treg, në rast se pjesa e tregut e të gjitha ndërmarrjeve së bashku, pjesëmarrëse në këtë marrëveshje, nuk tejkalon 10 % të tregut përkatës, ku pjesëmarrësit janë konkurrentë aktualë ose potencialë ose 15 % të tregut përkatës, ku pjesëmarrësit nuk janë konkurrentë aktualë ose potencialë.

- **Pozita dominuese**

Një ndryshim tjetër është rishikimi i dispozitave për abuzimin me pozitën dominuese për ta përafroar plotësisht me legjislacionin europian. Në ligjin e ndryshuar është hequr pika 3 e nenit 9 e cila nuk konsideronte abuzive praktikën e ndërmarrjeve në treg kur provonin se i kishin kryer për arsye objektive si psh teknike ose arsye të ligjshme tregtare. Ky ndryshim ishte i domosdoshëm jo thjesht për përafrimin e ligjit, por linte mundësi interpretimi nga çdo ndërmarrje që abuzon me pozitën dominuese që mund ta 'justifikonte' sjelljen e saj për arsye teknike apo të ligjshme tregtare, si psh maksimizimi i të ardhurave që është objektivi i çdo monopoli deri dje mund të konsiderohej për arsye tregtare.

- **Përqëndrimet e ndërmarrjeve**

Në versionin e amendimeve që u dekretuan ndryshimet parashikojnë koncepte të lidhura me nenin 3 të Rregullores 139/2004 "Për kontrollin e përqendrimeve" dhe konkretisht:

- a) se do të konsiderojmë përqendrim vetëm kur ka një ndryshim të konsiderueshëm në strukturën e kontrollit;
- b) në rastin kur një person fizik që kontrollon një ndërmarrje përfiton kontroll edhe mbi një ndërmarrje tjetër.

Lidhur me amendimet e nenit 12 ajo çfarë është evidentuar lidhet me uljen e konsiderueshme që ju bë pragjeve nga të cilët i lind detyrimi i ndërmarrjeve, që përqendrohen, për ta njoftuar atë në Autoritet. Në ligj jepen tre vlera sipas kriterëve të nenit 12 dhe konkretisht: 7 miliardë lek për xhiron në tregun e tashtëm; 400 milion lek për xhiron në tregun e brendshëm të të gjitha ndërmarrjeve; 200 milion lek për xhiron e vetëm një ndërmarrjeje ne te dy rastet.

Po kështu edhe në këtë dispozitë, u pa e arsyeshme zgjatja e afatit të njoftimit nga 1 javë në 30 ditë. Një risi është realizuar në nenin 13 të ligjit. Me amendimin e miratuar përafrohet testi ekzistues (vetëm ai Dominancës) me atë

Rregullores 139/2004 të BE-së e cila e sheh Testin edhe nga këndvështrimi i kufizimit të ndjeshëm të konkurrencës.

- **Gjobat**

Përafrimi i plotë i legjislacionin kërkonte edhe heqjen e kufirit të poshtëm të gjobave të rënda (i cili në ligjin e vjetër ishte 2 %) duke përcaktuar që këto gjoba janë në varësi të shkeljes dhe xhiros në tregun përkatës ku ka ndodhur shkelja (abuzim me pozitën dominuese, pjesëmarrje në një marrëveshje të ndaluar, realizim i një përqëndrimi pa marrë autorizimin e Autoritetit të Konkurrencës) dhe nuk mund të kalojnë shifrën 10 % të xhiros totale.

- **Procedurat Hetimore**

Këto dispozita përfshihen në Pjesën e III-të të Ligjit. Në to është patur parasysh që të përafrohen maksimalisht me Rregulloren 1/2003 të BE-së. Nga kjo pikëpamje nenet 33-35 janë përafuar me nenet 18-21 të Rregullores 1/2003. Po kështu është shtuar edhe dispozita që lidhej me trajtimin e ankesës dhe ruajtjen e fshehtësisë së identitetit të ankuesit. Procedimi sipas kësaj dispozite krijon parakushte për një garanci më të plotë të personave që mund të jenë në kontakt të drejtpërdrejtë me shkelje konkrete të konkurrencës.

- **Ankesat**

Gjatë gjithë kohës Autoriteti i Konkurrencës i ka kushtuar shumë rëndësi ndërgjegjësimit të biznesit dhe konsumatorëve për tu ankuar pranë Autoritetit për praktikën e mundshme antikonkurrese. Por në ligjin e ndryshuar është parashikuar një nen i veçantë për ankesat duke garantuar mbetjen anonim të ankuesit, sa herë që ky i fundit e kushtëzon një gjë të tillë.

- **IV.1.1 Miratimi i akteve nënligjore**

Autoriteti i Konkurrencës edhe këtë vit i ka kushtuar një rëndësi të veçantë plotësimin të kuadrit ligjor dytësor me aktet e nevojshme të cilat janë përshtatur dhe përafuar nga legjislacioni evropian në fushën e konkurrencës. Në këtë mënyrë institucioni ka zbatuar edhe detyrimet dhe afatet kohore të përcaktuara në Planin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA). Aktet e miratuara nga Komisioni i Konkurrencës kanë qenë objekt diskutimi edhe nga ekspertët të ndryshëm ndërkombëtarë në fushën e konkurrencës, por janë marrë parasysh edhe sugjerimet dhe vërejtjet e palëve të interesit brenda vendit, të tilla si studiot ligjore etj. Konkretisht Komisioni i Konkurrencës gjatë këtij viti ka miratuar këto akte:

- Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 137, datë 05.02.2010, ka miratuar Udhëzimin “Për vlerësimin e marrëveshjeve horizontale”. Ky udhëzim paraqet parimet për vlerësimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit horizontal. Në shumicën e rasteve

bashkëpunimi horizontal i referohet bashkëpunimit midis konkurruesve. Ky udhëzim mbulon marrëveshjet ose praktikat e bashkërenduara të lidhura ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjeve që veprojnë në të njëjtin nivel të tregut për shembull, në të njëjtin nivel prodhimi ose shpërndarje, duke përcaktuar dhe kriteret për vlerësimin e marrëveshjeve të Kërkim & Zhvillimit, prodhimit, blerjes, tregtimit, standardizimit dhe marrëveshje të mjedisit. Udhëzimi është në përputhje me njoftimin e Komisionit “Udhëzues mbi zbatimin e nenit 81 të Traktatit të KE për marrëveshjet e bashkëpunimit horizontal” (OJ C3, 6.1.2001; P. 2 – 30)(32001 Y 0106 (01));

- Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 145, datë 15.04.2010 ka miratuar Udhëzimin “Për vlerësimin e marrëveshjeve vertikale”. Ky udhëzim shpreh parimet për vlerësimin e këtyre lloj marrëveshjesh, duke dalluar efektet pro-konkurruese që sjellin këto lloj marrëveshjesh me efektet anti-konkurruese që sjellin ato marrëveshje, të cilat janë të ndaluara në bazë të ligjit. Udhëzimi është në përputhje me njoftimin e Komisionit European (2000/ C 291/01) “Udhëzimi mbi kufizimet vertikale” (32000Y1013(01)).

Në proces hartimi dhe miratimi në vitin që shkoi ishte Rregullorja “Për procedurat hetimore në zbatim të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Kjo rregullore synon përafrimin plotësisht me Rregulloren e Këshillit(EC) nr 1/2003 të datës 16 Dhjetor 2002 “Për zbatimin e rregullave të konkurrencës të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të Traktatit”(OJ L1, 04.01.2003, p 1-25) (32003R0001). Kjo rregullore është draftuar nga ekspertët e projektit që asistojnë stafin e Autoritetit dhe është diskutuar me grupin e punës të ngritur me qëllim draftimin e kësaj rregulloreje. Rregullorja respekton dispozitat ligjore në fuqi në fushën e konkurrencës dhe parashikon procedurat hetimore që ndjek Autoriteti i Konkurrencës.

Në proces draftimi janë edhe disa akte të tjera nënligjore, të cilat plotësojnë kuadrin ligjor të Autoritetit të Konkurrencës si dhe janë në mbështetje të nenit 6 të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i cili parashikon detyrimin e Autoritetit të Konkurrencës që të draftojë rregullore për përjashtimin në bllok të kategorive të marrëveshjeve. Konkretisht përmendim (i) Projekt- rregulloren “Për kategoritë e marrëveshjeve të specializimit” (në përputhje me Rregulloren e BE-së Nr. 2658/2000, datë 29.11.2000 “Mbi aplikimin e nenit 81/3 të Traktatit për marrëveshjet e specializimit”);(ii) Projekt- rregulloren “Për kategoritë e marrëveshjeve të transfertave teknologjike” (në përputhje me Rregulloren e KE nr 772/2004 të datës 27 Prill 2004 “Mbi aplikimin e nenit 81/3 të Traktatit për kategoritë e marrëveshjeve të transfertave teknologjike”); (iii) si dhe Projekt-rregulloren “Për kategoritë e marrëveshjeve të kërkim zhvillimit (në përputhje me rregulloren e Komisionit Nr. 2659/2000, 29 Nëntor 2000 “Mbi aplikimin e nenit 81, paragrafi 3, të traktatit të marrëveshjes së kërkimit dhe zhvillimit”).

- **Rregulloret e amenduara në kuadrin ligjor sekondar**

Pas amendimeve që pësoi Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar) Autoriteti i Konkurrencës ndërmori nismën e rishikimit të kuadrit ligjor dytësor në fuqi duke e përshtatur me ligjin e përditësuar. Ndër aktet të cilat u rishikuan përmendim:

- Rregullorja “Për marrëveshjet me rëndësi të vogël” miratuar me Vendimin e KK nr. 164, datë 14.12.2010 “Për një ndryshim në Rregulloren “Për marrëveshjet me rëndësi të vogël”;
- Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve” miratuar me vendimin e KK-së nr. 165, datë 14.12.2010 “Për disa ndryshime në Rregulloren “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve””;
- Rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve dhe ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës” miratuar me vendimin e KK-së nr 167, datë 21.12.2010 “Për një ndryshim në Rregulloren “Për caktimin e shpenzimeve dhe ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës””;
- Rregullorja “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës” miratuar me vendimin e KK-së nr 168, datë 21.12.2010 “Për një ndryshim në Rregulloren “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës””.

Miratimi i amendimeve të Ligjit 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” nëpërmjet miratimit në Kuvend të Ligjit nr. 10 317, datë 16.09.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.9121 dt.28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” shtroi përpara stafit të Autoritetit të Konkurrencës domosdoshmërinë e shoqërimit të këtyre ndryshimeve edhe në akteve nënligjore të mëparshme të dala në zbatim të dispozitave para amenduara. Dispozitat e amenduara kërkonin patjetër të gjenin pasqyrim në detajimin dhe interpretimin e tyre në dispozitat respektive të rregulloreve dhe njëkohësisht në raste të veçanta shtronin dhe nevojën e hartimit të rregulloreve të reja të cilat më parë nuk mundësoheshin për shkak të mungesës së bazës ligjore referuese në ligj.

Në këtë mënyrë Autoriteti brenda një periudhe të shkurtër disa javore, pa neglizhuar edhe detyrimet e përditshme, amendoi të gjitha rregulloret ekzistuese në harmoni të plotë me ndryshimet ligjore, si dhe me rast hartoi edhe rregullore të reja të kushtëzuara tashmë nga nevojat e kohës dhe të diktuar nga baza e re ligjore e krijuar me ndryshimet ligjore.

IV.2 Pyetësori i Komisionit European- Politika e Konkurrencës

Pas dorëzimit të kërkesës për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në BE (në 28 Prill 2009), Qeveria Shqiptare mori në dorëzim Pyetësorin e KE-së. Procesi i hartimit të përgjigjeve që Autoriteti i Konkurrencës do t'i jepte pyetjeve të Pyetësorit të KE-së, ishte një nga sfidat e rëndësishme me të cilën u ballafaqua institucioni ynë, duke qenë se vetë Autoriteti i Konkurrencës kishte një kapitull të veçantë (Kapitulli 8 “Politika e Konkurrencës”), i cili përbëhej nga tre pjesë: Konkurrenca (antitrusti), Ndihma Shtetërore, dhe Liberalizimi, për të cilin ishte dhe institucioni përgjegjës që koordinoi punën për hartimin e përgjigjeve.

Autoriteti i Konkurrencës filloi punën përgatitore për koordinimin e procesit të hartimit të përgjigjeve të Pyetësorit, duke ngritur për këtë qëllim grupin e tij të punës me Urdhrin nr. 368/2, datë 10.12.2009 “Për ngritjen e grupeve ndër-institucionale të punës dhe caktimin e listës së personave lidhur me Pyetësorin e BE-së”, pas daljes së Urdhrit të Kryeministrit nr. 183, datë 11.12.2009, “Për ngritjen e Grupeve

Ndërinstitucionale të Punës”. Në këtë proces u përfshinë ekspertët e Autoritetit të cilët hartuan përgjigjet, të cilat u diskutuan dhe u miratuan nga strukturat drejtuese të institucionit. Gjatë këtij procesit u zhvilluan shumë takime ndërinstitucionale me institucione dhe ente të ndryshme rregullatorë të cilët ishin pjesë e grupit ndërinstitucional të punës me qëllim përgatitjen e përgjigjeve për pyetjet e integruara.

Autoriteti punoi për koordinimin dhe mbarëvajtjen e këtij procesi me institucione të tjera shtetërore të përfshirë në dhënien e përgjigjeve, për të shmangur çdo vonesë apo pasaktësi në dhënien e tyre. Institucionet kontribuuese për këtë kapitull janë: Autoriteti i Konkurrencës, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë Informacionit e të Komunikimit, Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit, AKEP, etj.

Kapitulli 8 përmbante 49 pyetje, nga të cilat 31 pyetje ishin në fushën e konkurrencës. Plotësimi me realizëm i pyetësorit mundësoi të realizohej një ballafaqim i së drejtës dhe i praktikës shqiptare të konkurrencës me atë europiane, proces i cili ishte shumë ndihmues për të identifikuar mungesat dhe problemet në bazën ligjore. Ky informacion u përdor për përsosjen e mëtejshme të amendimeve të ligjit të propozuara. Një aspekt tjetër që duhet nënvizuar është përgatitja e pjesës së liberalizimit e cila u mundësua nga një bashkëpunim shumë i ngushtë midis grupit ndërinstitucional i cili do të vazhdojë të funksionojë në mënyrë të vazhdueshme.

Në Qershor 2010, Autoriteti i Konkurrencës iu përgjigj pyetjeve shtesë (konkretisht 8), duke respektuar afatet kohore të vendosura nga Ministria e Integritimit.

IV.3 Asistenca teknike e Komisionit Europian

Pranë Autoritetit të Konkurrencës ka filluar implementimi i projektit “Mbështetje për Autoritetin e Konkurrencës dhe Departamentin e Ndhmës Shtetërore” i cili është pjesë e programit IPA 2008, të financuar nga BE me vlerë 1.5 milion Euro, me një shtrirje kohore 24 muaj. Projekti është i ndarë në Asistencën Teknike (500.000 Euro) dhe Projektin e Binjakëzimit (1 milionë Euro) i zbatuar nga ekspertët e Autoriteteve homologe Italiane dhe Hungareze për pjesën e konkurrencës. Nëpërmjet këtij projekti pritet që Autoritetit të Konkurrencës të jetë një institucion i cili të kombinojë praktikën shqiptare me standardet me të mira europiane, duke përthithur ato standarde të cilat janë të zbatueshme duke synuar ofrimin e një mjedisi konkurrues në Shqipëri.

Objektivi i këtij projekti është sigurimi i një mjedisi konkurrues në Shqipëri nëpërmjet ndihmesës që do të jepet në kuadrin ligjor, lidhur me publikimet, ndërgjegjësimin të kulturës dhe advokacisë së konkurrencës, përkthimeve, ofrimit të ekspertizës, organizimit të aktiviteteve të ndryshme etj, drejt përsheptimit dhe përmirësimit të procedurave si dhe rritjes së kapaciteteve administrative, duke synuar një përputhshmëri graduale të kësaj fushe me atë të BE-së, të cilat do të përshpejtojnë procesin e integrimin të Shqipërisë në BE.

Projekti do të ofrojë asistencë teknike në amendimin dhe përmirësimin e legjislacionit shqiptar në fushën e konkurrencës me atë evropian, rishikimin e procedurave dhe implementimin e kuadrin ligjor me qëllim sigurimin e harmonizimit të plotë të legjislacionit shqiptar me “acquis”, si dhe duke ofruar dhe sugjeruar mjetet e

nevojshme të cilat do të mundësojnë rritjen e zbatueshmërisë së vendimeve të marra në fushën e konkurrencës.

Projekti synon të rrisë dhe të forcojë efikasitetin dhe efektivitetin e kapaciteteve administrative në fushën e konkurrencës. Ndërmjet të tjerave projekti do të fokusohet:

në shkëmbimin e eksperiencës në shqyrtimin e rasteve në fushën e konkurrencës;
në forcimin e kapaciteteve të institucionit, rritjen e profesionalizmit, shkëmbim eksperience dhe përvoja me institucionet homologe Italiane dhe Hungareze;
në asistencën teknike të ofruar për amendimin dhe përmirësimin e legjislacionit shqiptar në fushën e konkurrencës me legjislacionin e BE, si dhe në përkthimin e Rregulloreve të Komisionit Evropian dhe dokumenteve të tjerë interpretues në zbatim të PKZMSA-së;
në rritjen e kulturës dhe ndërgjegjësimin e publikut në fushën e konkurrencës nëpërmjet organizimit të një sërë aktiviteteve kombëtare dhe më gjerë (seminare trajnuese të përbashkëta dhe konferencave, workshopeve, etj) të cilat janë një mjet i nevojshëm për kuptimin e kuadrit ligjor të konkurrencës si dhe organizimi i tavolinave të rrumbullakëta që do të trajtojnë çështje të ndryshme të konkurrencës;
në publikimin e legjislacionit shqiptar dhe broshurave të tjerë informative;
në kryerjen e një sërë aktiviteteve të tjera të cilat përshijnë trajnimin e gjyqtarëve, mediave, studiove ligjore dhe komunitetit të biznesit etj për aspekte të ndryshme të konkurrencës, asistencë në intensifikimin dhe konsolidimin e zbatueshmërisë së ligjit, etj.

IV.4. Bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare

Autoriteti i Konkurrencës ka konsoliduar marrëdhëniet me autoritetet homologe dhe ka patur një komunikim të vazhdueshëm me homologët nëpërmjet kontakteve dhe shkëmbimit të eksperiencës. Pjesëmarrja gjithnjë e më aktive në veprimtaritë e organizuara prej organizmave ndërkombëtarë është një domosdoshmëri në njohjen dhe përditësimin me tendencat më të fundit në fushën e konkurrencës, si dhe zbatimin e parimeve dhe praktikave më të mira.

Duke qenë se Autoriteti i Konkurrencës është anëtar i Rrjetit Ndërkombëtar të Konkurrencës, ka qenë i ftuar në aktivitetet e ndryshme të zhvilluara nga ICN në fushën e konkurrencës si dhe ka plotësuar formularët dhe iu është përgjigjur kërkesave drejtuar institucionit tonë nga ky organizëm.

V. Synimet kryesore të punës për vitin 2011

Ekspierienca e deritanishme e funksionimit të institucionit të konkurrencës mundëson identifikimin e problematikave të së kaluarës dhe sfidave të së ardhmes. Sikurse është nënvizuar kapacitetet administrative dhe nivelin e ekspertizës së personelit përbën një nga faktorët kyç të rritjes të ndikimit në treg të mbikëqyrësit të lojës së operatorve. Advokacia e konkurrencës dhe liberalizimi i mëtejshëm i tregjeve përbëjnë

instrumentat thelbësorë të nxitjes dhe konsolidimit të konkurrencës dhe nxjerr në pah karakteristikat e lojës së lojtarve në treg.

V. 1. Mbikqyrja e tregjeve

Mbikqyrja e tregjeve është detyrimi kryesor ligjor, përmbushjen të cilit institucioni i konkurrencës e ka pjesë të konsiderueshme të planit të punës. Pra, monitorimi dhe hetimi i tregjeve duhet të mbetet nje nga prioritetet kryesore të punës së Autoritetit të Konkurrencës gjatë vitit 2011 për sigurimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.

Sektorët dhe tregjet kryesore mbi të cilat do të jetë fokusuar mbikqyrja janë ata në të cilët përqëndrimi dhe fuqia e firmave është e madhe ose numri i konkurrentëve është i kufizuar si pasojë e strukturës së tregut (monopolet natyrore) apo krijimit të pozitës dominuese nga një ose disa operatorë në tregjet përkatëse të produktit.

Lidhur me praktikën antikonkurrese të marrëveshjeve të ndaluara apo praktikave bashkërenduese është vënë re se gjithmonë e më shumë, marrëveshjet midis ndërmarrjeve po sofistikohen duke e bërë gjithmonë dhe më të vështirë zbulimin e tyre nga ana e Autoritetit të Konkurrencës nëpërmjet evidencave direkte. Për këtë arsye ndër prioritetet e Autoritetit të Konkurrencës për vitin që vjen përfshin përmirësimin e metodave për zbulimin e praktikave anti-konkurrese dhe veçanërisht ato të marrëveshjeve duke rritur zbulueshmërinë nëpërmjet teknikave alternative si dhe duke përdorur gjerësisht analizat ekonomike.

Lidhur me kontrollin e përqëndrimeve, me ndryshimet e Ligjit ku u ulën ndjeshëm kufijtë e xhiros për njoftimin e përqëndrimeve, pritet rritje e ndjeshme e numrit të rasteve që do të kërkojnë miratimin e Komisionit të Konkurrencës. Autoriteti i Konkurrencës ka propozuar shtimin e strukturës me dy inspektorë për të siguruar kapacitetet e nevojshme administrative për ndjekjen e procedurave të kontrollit të përqëndrimeve.

Gjatë vitit në vijim, Autoriteti i Konkurrencës do të përfundojë monitorimet dhe hetimet që ka në proces si dhe do të trajtojë me përgjegjësi dhe profesionalizëm të gjitha ankesat apo shenjat që do t'i adresohen direkt apo indirekt.

V.2 Liberalizimi dhe të drejtat ekskluzive

Ndryshimi më kryesor në Ligjin "Për mbrojtjen e konkurrencës" është përfshirja në objektin e Ligjit të ndërmarrjeve publike dhe ndërmarrjeve, të cilave u janë dhënë nga shteti të drejta ekskluzive ose të drejta të veçanta. Me hyrjen në fuqi të Ligjit Autoriteti i Konkurrencës i është drejtuar të gjitha institucioneve qendrore dhe enteve rregullatore që të kërkojnë vlerësimin e Komisionit të Konkurrencës përpara se të garantohen të drejtat ekskluzive dhe speciale

Sfida e Autoritetit të Konkurrencës është vlerësimi ex-ante i të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore që mund të garantojnë të drejta ekskluzive për një ndërmarrje të caktuar, qoftë kjo publike apo private, të cilës mund t'i garantohen nga organet qendrore ose vendore, por që mund të kufizojnë konkurrencën për produkte ose shërbime në treg. Në këtë mënyrë do të rritet forca parandaluese ndaj shtrembërimeve të konkurrencës që rrjedhin nga aktet normative.

Autoriteti i Konkurrencës ka administruar informacionin mbi statusin aktual të tregjeve dhe sektorëve të ekonomisë ku numri i operatorëve është i kufizuar dhe po punon ngushtësisht me institucionet qendrore e në mënyrë të veçantë me Ministrinë e Ekonomisë dhe atë të Transportit për marrjen e masave për liberalizimin e tregjeve.

Autoriteti i Konkurrencës në bashkëpunim me ekspertët është në proces draftimi të një analize mbi liberalizimin në tregjet që janë të identifikuar me operatorë me të drejta ekskluzive të garantuara me akte normative. Ky material do të diskutohet me institucionet përkatëse për të identifikuar hapat e mëtejshëm që do të duhet të ndërmerren. Në axhendën e punës së Autoritetit për vitin 2011 do të jetë monitorimi i një numri ndërmarrjesh në transport, shërbime publike, shërbime postare dhe sektorin energjetik ku janë dhënë të drejta të veçanta dhe ekskluzive. Ashtu siç rekomandon dhe Komisioni European, Autoriteti i Konkurrencës në bashkëpunim me institucionet qendrore dhe/ose entet rregullatore do të kryejë analiza të mëtejshme mbi përputhshmërinë e këtyre praktikave të të drejtave ekskluzive me *acquis communautaire*.

V.3 Rritja e advokatisë dhe kulturës së konkurrencës

Avokatësia dhe forcimi i kulturës së konkurrencës është jo vetëm një nga shtyllat e ligjit, por përbën një domosdoshmëri jetike për një efekt real të aktivitetit të Autoritetit të Konkurrencës për një treg funksional.

Veprimtaria efektive e Autoritetit të Konkurrencës, në zbatim të Politikës dhe Ligjit për konkurrencën, ndikohet nga perceptimi dhe reagimi i të gjithë aktorëve të tregut, që preken nga kjo veprimtari. Për këtë arsye, me ekspertizën e konsulencës së asistencës teknike është mundësuar draftimi i një strategjie në rritjen e advokacisë, e cila përbën një plan pune të detajuar zbatim i të cilit është një nga prioritetet kryesore të punës së Autoritetit.

Në paraqitjen e aktivitetit për vitin 2010 është paraqitur puna e bërë për të qënë pjesë integrale e gjithë paketës ligjore të RIA-së, një inisiativë e Qeverisë Shqiptare, e cila është në fazën e konsultimit. Nëpërmjet kësaj pakete do të mundësohet zbatimi i detyrimit ligjor për institucionet qendrore dhe vendore që të kërkojë vlerësimin e Autoritetit të Konkurrencës për çdo projekt akt normativ që, në mënyrë të veçantë, ka të bëjë me (a) kufizimet sasiore për hyrjen në treg dhe tregtimin; (b) vendosjen e të drejtave ekskluzive ose të të drejtave të veçanta, në zona të caktuara, për ndërmarrje ose për produkte të caktuara; dhe (c) imponimin e praktikave të njëjta në çmime dhe kushtet e shitjes.

Për rritjen e kulturës së konkurrencës Autoriteti i Konkurrencës përdori disa instrumenta, të tilla si tërheqja e opinionit të komunitetit të biznesit për punën e institucionit të konkurrencës nëpërmjet teknikës së pyetësorit, i cili parashikohet të realizohet në bashkëpunimin me komunitetin e biznesit si në nivel qendror ashtu edhe në nivel lokal. Gjithashtu, autoriteti do të vazhdojë që të punojë për ngritjen dhe forcimin e një partneriteti real me biznesin nëpërmjet dhe organizatat përfaqësuese të tij rrisë bashkëpunimin me dhomat e tregtisë që grupojnë biznese të huaja dhe vendase si Dhoma Amerikane e Tregtisë, Dhoma Gjermane e Tregtisë, Dhoma Angleze e Tregtisë etj.

Një instrument tjetër për rritjen e advokatisë së ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, janë seminarët dhe trajnimet me ekspertë ndërkombëtarë të financuar nga TAIEX-i, Programi i Binjakëzimit dhe Programi i Asistencës teknike të Bashkimit Evropian. Këto aktivitete do të zhvillohen me pjesëmarrjen e bizneseve, gjyqësorit dhe institucioneve të ndryshme publike. Në këtë mënyrë do të shërbejnë jo vetëm për rritjen e njohurive të këtyre aktorëve mbi politikën e konkurrencës por edhe si një forum për të krijuar ura të mëtejshme bashkëpunimi.

Në këtë mënyrë edhe gjatë vitit 2011 do të vazhdojë konsultimi me aktorët e tregut, si institucionet publike dhe rregullatorë, studiot ligjore dhe përfaqësuesit e sistemit të drejtësisë, komunitetin e biznesit dhe përfaqësuesit e qeverisë qendrore dhe vendore në drejtim të promovimit të ndryshimeve të kryera në ligjin bazë si dhe përmirësimin e kuadrit ligjor në fushën e konkurrencës.

Edhe mediat përbëjnë një nga partnerët e rëndësishëm të Autoritetit të Konkurrencës, për rritjen e transparencës së këtij institucioni nga njëra anë ashtu edhe për rritjen e kulturës së konkurrencës të publikut të gjerë nga ana tjetër, në përgjithësi dhe të rasteve e hetimeve të veçanta. Për këtë arsye Autoriteti i Konkurrencës do të vazhdojë bashkëpunimin e gjerë dhe të gjithanshëm me median e shkruar dhe audiovizuale.

Autoriteti i Konkurrencës do të vazhdojë bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë me qëllim nxitjen e studimit të konkurrencës si në aspektin juridik ashtu edhe atë ekonomik, si dhe përfshirjen e studentëve në punën e Autoritetit të Konkurrencës në drejtim të kryerjes së intershipeve dhe/ ose praktikave mësimore, duke përdorur këto potenciale për realizimin e pyetësorëve për studimet e tregut.

V.4 Forcimi i kapaciteteve administrative

Forcimi i kapaciteteve administrative është një sfidë e vazhdueshme e institucioneve publike në procesin e integritit evropian. Por, për punonjësit e Autoritetit të Konkurrencës kjo sfidë është e shumëfishtë, pasi u duhet të rrisin performancën e tyre në një ambjent ku shenjat e faktorët që ndikojnë në evidentimin e sjelljes së operatorve të tregut bëhen më të sofistikuar. Autoritetit i duhet të ballafaqohet me operatorë të fuqishëm të tregjeve me burime dhe mjete të shumta. Në mënyrë më specifike rritja e shkallës së ekspertizës në teknikat investigative dhe në analizat sasiore do të jenë objektivi kryesor i investimit në kapacitetet administrative.

Duke parë dhe rekomandimet e Komisionit Evropian për rritjen e kapaciteteve, në përgjigje të ndryshimeve të Ligjit, është patur parasysh një ndryshim jo thelbësor i strukturës së Autoritetit që parashikon vetëm zgjerimin e Sektorit të Kontrollit të Përqëndrimeve nga 3 në 5 inspektorë për të përballuar pritshmërinë në rritje të rasteve të përqëndrimeve që do t'i njoftohen Autoritetit të Konkurrencës.

Gjatë vitit 2011 Autoriteti i Konkurrencës ka parashikuar një matricë trajnimesh të financuar nga OECD dhe fondet e buxhetit që mbulon të gjitha fushat e veprimtarisë së tij si politikën e konkurrencës, marrëveshjet e ndaluara, abuzimin me pozitën dominuese dhe kontrollin e përqëndrimeve ku parashikohet të trajnohen pjesa më e madhe e stafit teknik të Autoritetit.

Në bashkëpunim me projektin e financuar nga BE për binjakëzimin e Autoritetit shqiptar të konkurrencës me homologët italianë dhe hungarezë, për këtë vit janë parashikuar dy

programe intershipi për të përfituar nga eksperiencia e dy vendeve anëtare të BE-së në zbatimin e Ligjit dhe Politikës së Konkurrencës.

Gjithashtu do të vijojnë intensivisht programet e trajnimit të financuara nga Bashkimi Europian nëpërmjet TAIEX, GTZ-së, Rrjetit Ndërkombëtar të Konkurrencës, Rrjetit Rajonal të Konkurrencës etj..

V.5 Konsolidimi i bashkëpunimit institucional dhe marrëdhënieve ndërkombëtare

Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe rajonal është një nga mjetet më të mira për të rritur efikasitetin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore të Autoritetit. Në këtë kuadër institucioni do të marrë pjesë aktivisht në aktivitete të ndryshme ndërkombëtare të zhvilluara nga Rrjeti Ndërkombëtar i Konkurrencës (ICN), OECD, Komisioni Europian etj. Këto aktivitete do të shërbejnë për prezantimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës në rrafshin ndërkombëtar, përfitimin nga eksperiencat më të mira ndërkombëtare e rajonale si dhe bashkëpunimin për hetime të përbashkëta e shkëmbim informacioni.

Autoriteti do të bashkëpunojë me institucionet homologe të vendeve si Greqia, Hungaria, Maqedonia, Kosova, Bullgaria etj, me të cilat janë nënshkruar marrëveshje dypalëshe bashkëpunimi. Gjithashtu do të synohet që të arrihet nënshkrimi i marrëveshjeve dypalëshe të bashkëpunimit me vende të tjera kryesisht të rajonit me qëllim bashkëpunimin për shkëmbim informacioni, hetime të përbashkëta etj.

Shtojcë 1-Të dhëna statistikore mbi vendimet e Komisionit të Konkurrencës sipas viteve

Viti	Vendimet ne Total	Përqendrime	Abuzimin me Pozitën Dominuese	Marrëveshjet e ndaluara	Përjashtime nga Marrëveshjet	Rregullore dhe Udhëzues	Rekomandime ndaj Institucioneve Publike	Vendime për vendosje Gjore	Vendime Te tjera
2004	13	2				6	1	-	4
2005	17	-				2	3	1	11
2006	14	4				-	1	1	8
2007	25	9	1	3		4	2	5	2
2008	29	11	1		1	4	5	-	7
2009	36	8	1	2	1	2	10	2	10
2010	34	6	3	2	-	7	5	2	9
Totali	168	40	6	7	2	25	26	11	51

Shtojce 2- Vendimet administrative(gjobat) e vendosura nga Komisioni i Konkurrencës

Nr.	Data	Ndërmarrjet	Përqindje xhiros	Shuma(lek)	Konfirmuar/Rezuar	Shkalla gjyqesorit	Faza e ekzekutimit nga Sherbimi Permbarimor
27	12.12.2005	AMC	1	160.000.000	konf,Shk,I,,Apeli,-rigjykim	gjykate,e,larte	Proces gjyqesor
38	16.05.2006	ÇALIK HOLD(BKT)		6.549.476	konf,shk,I,,konf,shk,II	gjykate,e,larte	Ne Proces ekzekutimi
50	21.03.2007	SIGMA	2	15.170.870	konfirmuar,shkall,I,,rrezuar,shkalla,II	gjykate,e,larte	Proces gjyqesor
		SIGAL	2	21.768.394	konfirmuar,shkall,I,,rrezuar,shkalla,II	gjykate,e,larte	Proces gjyqesor
		INSIG	2	28.151.049	konfirmuar,shkall,I,,rrezuar,shkalla,II	gjykate,e,larte	Proces gjyqesor
		EUROSIG	2	1.654.026	konfirmuar,shkall,I,,rrezuar,shkalla,II	gjykate,e,larte	Proces gjyqesor
		ATLANTIK	2	8.207.318	konfirmuar,shkall,I,,rrezuar,shkalla,II	gjykate,e,larte	Proces gjyqesor
		INTERSIG	2	6.969.233	konfirmuar,shkall,I,,rrezuar,shkalla,II	gjykate,e,larte	Proces gjyqesor
		INTERALBANIAN	2	5.008.708	konfirmuar,shkall,I,,rrezuar,shkalla,II	gjykate,e,larte	Proces gjyqesor
		ALBSIG	2	3.900.773	konfirmuar,shkall,I,,rrezuar,shkalla,II	gjykate,e,larte	Proces gjyqesor
59	09.11.2007	AMC	2	211.552.000	fituar,shkalla,e,pare, e dyte	Gjykate e Larte	Ne Proces ekzekutimi
		VODAFONE	2	242.633.000	fituar,shkalla,e,pare	Apel	Proces gjyqesor
63	3.12.2007	PROCREDIT		7.237.464	fituar,shkalla,I, Shkalla e Dyte,	Forme e Prere	Ne Proces ekzekutimi
66	18.12.2007	ALBAN,TIRANA		447.915	konfirmuar,shk,I, Shkalla e Dyte	Forme e Prere	Ne Proces ekzekutimi
		BEST,CONSTRUCT		235.367	u,pushua,nga,gjykata	forme,e,prere	Ne Proces ekzekutimi
		BETON,EXPRESS		178.534	e,pa-apeluar	forme,e,prere	Ne Proces ekecutimi
		FERRO,BETON		436.959	e,paapeluar	forme,e,prere	Ne Proces ekzekutimi
		HALILI,		172.519	e,paapeluar	forme,e,prere	Ne Proces ekzekutimi
		ITAL-BETON		201.086	e,paapeluar	forme,e,prere	Ne Proces ekzekutimi
		KIRCHBEGER		508.279	e,paapeluar	forme,e,prere	Ne Proces ekzekutimi
		QARRI-02		169.652	e,paapeluar	forme,e,prere	Ne Proces ekzekutimi
		SHKODRA,BETON		396.974	konfirmuar,ne,Shk,I,,shkalle,e,dyte	forme,e,prere	Ne Proces ekzekutimi
67	24.12.2007	KAJO,HALKA		30.000	e,paapeluar	forme,e,prere	Ne Proces ekzekutimi
123	18.09.2009	ALBANIAN AITLINES MAK,shpk		2.600.000	pa,apeluar	Forme e Prere	Ne Proces ekzekutimi
125	08.10.2009	BLOJA SHA		38.548.251	Humbur, shkalla e pare	Gjykata e Apelit Tirane	Ne proces gjyqesor
		ATLAS SHA		27.848.563	E ankimuar	Gjykim ne shkalle te pare	Ne proces gjyqesor
150	20.07.2010	ARMO SH.A		271.880.720	E ankimuar	Gjykim ne shkalle te pare	Ne proces gjyqesor
154	01.10.2010	CLASICC SHPK		25.712.000	E ankimuar	Gjykim ne shkalle te pare	Ne proces gjyqesor
		ULTRAMOTORS		1.517.000	E ankimuar	Gjykim ne shkalle te pare	Ne proces gjyqesor
		NOTI SHPK		2.994.000	E ankimuar	Gjykim ne shkalle te pare	Ne proces gjyqesor
		HYNDAY		5.383.000	E ankimuar	Gjykim ne shkalle te pare	Ne proces gjyqesor
		Shuma totale e gjobave		1.093.263.130			

Shtojcë 3: Matrica e vlerësimeve dhe rekomandimeve të Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2010

Nr.	Vendimi	Rekomandimi i Autoritetit të Konkurrencës	Sa është marrë në konsideratë
1	Vendimi i Komisionit të Konkurrencës nr. 142 , dt. 15.03.2010 "Për mbylljen e hetimit të thelluar ndaj "Raiffeisen Bank" Sh.a për abuzim me pozitën dominuese në tregun primar dhe sekondar të bonove të thesarit dhe përcaktimi i kushteve dhe detyrimeve për "Raiffeisen Bank" Sh.a".	Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit nr. 142 , dt. 15.03.2010 "Për mbylljen e hetimit të thelluar ndaj "Raiffeisen Bank" Sh.a për abuzim me pozitën dominuese në tregun primar dhe sekondar të bonove të thesarit dhe përcaktimi i kushteve dhe detyrimeve për "Raiffeisen Bank" Sh.a", vendosi: 1. "Mbylljen e hetimit të thelluar ndaj <u>Raiffeisen Bank SHA</u> për abuzim me pozitën dominuese në tregun primar dhe sekondar të bonove të thesarit 2. <i>Vendosjen e kushteve dhe detyrimeve ndaj Raiffeisen Bank SHA mbi bazën e angazhimeve të shprehura nga banka në seancën dëgjimore:</i> <i>I. Uljen e komisioneve që i tarifohen individëve në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në tregun primar. Këto komisione duhet të ulen në masën 50%, për një periudhë 3 vjeçare, me qëllim që të nxitet dhe të rritet pjesëmarrja e individëve në tregun primar.</i> <i>II. Korrigjimet për të përmirësuar dhënien e informacionit mbi BTH tek publiku si më poshtë:</i> <i>a. RB do të hartojë ad hoc material mbi marketingun që do të ekspozohet dhe/ose shpërndahet në secilën prej degëve të saj.</i> <i>b. Në çdo degë do të shfaqen në mënyrën e duhur tendencat e yield-it të BTH të përditësuara në kohë.</i> <i>c. Informacioni rreth BTH do të jetë i publikuar në faqen e internetit të RB nëpërmjet një linku të identifikueshëm.</i>	Është marrë në konsideratë. Raiffeisen Bank ka miratuar uljen e komisioneve nga 1.2% në 0.6%. Banka ka përgatitur një broshurë informuese për bonot e thesarit të cilën e ka vendosur në të gjitha pikat. Gjithashtu RB në faqen e internetit ka publikuar të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me bonot e thesarit.
2	Vendimi i Komisionit të Konkurrencës nr. 143 , dt. 15.03.2010 "Mbi disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun primar dhe sekondar të bonove të thesari".	Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit nr. 143 , dt. 15.03.2010 "Mbi disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun primar dhe sekondar të bonove të thesarit", vendosi: "1. <i>T'i propozojë Bankës së Shqipërisë të rikthejë depozitimin "cash" në sportelet e saj në Tiranë dhe në 5 rrethet kryesore ku ajo ka degë për pjesëmarrjen në ankandet e tregut primar të bonove të thesarit si një mënyrë efektive për eliminimin e kostos së transaksionit të shumave të investuara për bono thesari nga bankat e nivelit të dytë drejt Bankës së Shqipërisë.</i>	Nuk është marrë në konsideratë. Depozitimi i parave për pjesëmarrje në ankandet e bonove të thesarit vijon të bëhet vetëm pranë bankave të nivelit të dytë.

	<p>2. Tí propozojë <u>Ministrisë së Financave</u> rritjen e marketingut të produktit të bonove të thesarit për të rritur gamën e pjesëmarrësve në ankandet e tregut primar të biznesit, institucionet financiare dhe individëve kryesisht nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Njoftimet publike të ankandëve të radhës (jo vetëm te TVSH dhe ATSH) por te të gjitha mediat e shkruara dhe elektronike. Përgatitja e fletëpalosjeve dhe broshurave të tjera informative për bizneset, klientët e bankave, shoqatat e konsumatorëve etj. • Marketing interaktiv nëpërmjet internetit dhe instrumentave të tjerë të komunikimit me publikun. • Marketing ndërkombëtar për bonot e thesarit për rritjen e pjesëmarrjes në tregun primar të bonove të thesarit. <p>3. Tí rekomandojë <u>Bankës së Shqipërisë</u> si autoritetit qëndror monetar marrjen e masave për reduktimin e asimetrisë së informacionit për klientët nga ana e bankave të nivelit të dytë</p> <p>Banka e Shqipërisë me anë të një akti nënligjor (rregullore/urdhër me fuqi detyruese për bankat e nivelit të dytë) të rregullojë problemin e asimetrisë së informacionit duke marrë masat si vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) Bankat e nivelit të dytë në çdo degë apo agjenci të tyre duhet të japin të dhëna të plota, të sakta dhe të qarta për klientët për të gjitha produktet, kostot dhe interesat respektive që ofron (përfshirë dhe bonot e thesarit) duke sqaruar kryesisht përfitimet e klientëve dhe duke krahasuar mundësitë e investimit (depozita kundrejt bono thesari) b) Në faqet e internetit të bankave të nivelit të dytë të shfaqen në kohë reale të dhënat e ankandëve të rradhës të bonove të thesarit dhe tendencat e përditësuara të yieldit të bonove të thesarit c) Bankat e nivelit të dytë duhet të informojnë klientët me instrumentat e parashikuar (email, telefon, faks) për ankandet e radhës të bonove të thesarit, shumat e kërkuara, afatet e depozitimit të parave për pjesëmarrje dhe të dhëna të tjera të kërkuara. d) Bankat e nivelit të dytë të kenë një seksion të veçantë për trajtimin e ankesave të klientëve në mënyrë të veçantë për asimetrinë e informacionit nga ana e nëpunësve të bankës; ç) Klientët që janë keqinformuar të përfitojnë të drejtën e dëmshpërblimit në rast të fitimit të munguar për shkak të asimetrisë së informacionit dhe/ose keqorientimit nga nëpunësit e bankës për pjesëmarrjen në tregun primar të bonove të thesarit; <p>4. Tí rekomandojë <u>Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare</u> rritjen e mbikëqyrjes në tregun me pakicë dhe transparencën e tij</p>	<p>Është marrë në konsideratë. Gjatë vitit 2010 ka patur një marketim më të mirë të produktit “bono thesari” si në tregun vendas ashtu dhe në atë ndërkombëtar (emetimi i eurobondit)</p> <p>Nuk ka informacion nga Banka e Shqipërisë Banka e Shqipërisë ka publikuar një broshurë informuese për bonot e thesarit.</p>
--	--	--

		<p><i>Në përmbushje të detyrimeve ligjore për mbikëqyrjen e tregut sekondar me pakicë të letrave me vlerë të qeverisë, AMF të mbikëqyrë në mënyrë periodike tregun e bonove të thesarit duke përgatitur raportet e mbikëqyrjes së këtij tregu (ashtu siç vepron me tregun e sigurimeve dhe me tregun e sigurimeve të pensioneve vullnetare) dhe të informojë Autoritetin, mbi problematikën e hasur në funksionimin e këtij tregu si pasojë e ndonjë kufizimi të mundshëm të konkurrencës. Të zhvillojë instrumentat e duhur për mbrojtjen konsumatore edhe për letrat me vlerë të qeverisë ashtu siç po vepron me mbrojtjen konsumatore për tregun e sigurimeve duke ngritur një njësi për trajtimin e ankesave të individëve që marrin pjesë në tregun e letrave me vlerë dhe mundësimin e dëmshpërblimit të dëmit konsumator të shkaktuar nga bankat e nivelit të dytë. ”</i></p>	
3	<p>Vendimi i Komisionit të Konkurrencës Nr. 144, datë 23.03.2010 “Rekomandim për Entin Rregullator të Enejjsë për Liçensimin e dy shoqërive “Cable System” sh.p.k dhe “400KV” sh.p.k”.</p>	<p>Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 144, datë 23.03.2010 “Rekomandim për Entin Rregullator të Enejjsë për Liçensimin e dy shoqërive “Cable System” sh.p.k dhe “400KV” sh.p.k, Vendosi:</p> <p><i>1. T’i rekomandojë Entin Rregullator të Enejjsë Elektrike të pajisë me liçencë për tregtimin e energjisë elektrike shoqëritë “Cable Sistem” sh.p.k dhe “400KV” sh.p.k.</i></p>	<p>Janë marrë në konsiderat, perkatesisht me vendimet: VKERE Nr.36, dt. 27.04.2010; VKERE Nr.37, dt.27.04.2010.</p>
4	<p>Vendimi i Komisionit të Konkurrencës Nr. 158, dt. 12.11.2010 i “Për disa rekomandime për parandalimin e marrëveshjeve në oferta në prokurimet publike”.</p>	<p>Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit Nr. 158, datë 12.11.2010 “Për disa rekomandime për parandalimin e marrëveshjeve në oferta në prokurimet publike”, Vendosi:</p> <p><i>I. Ti rekomandoje Agjencisë se Prokurimit Publik, Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit të Shqipërisë, për:</i></p> <p><i>1. Amendimin e Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, në nenin 13, pika 3, sipas se cilës APP përjashton një operator ekonomik nga pjesëmarrja ne procedurat e prokurimit për një periudhe 1-3 vjet për rastet e propozuara sipas germave a, b,c, ç te kësaj pike, ku te shtohet, germa d, me përmbajtje si vijon:</i></p> <p>“d) Për rastet kur me Vendim te Komisionit te Konkurrencës është zbuluar ekzistenca e një marrëveshje ne oferta midis operatoreve ekonomike pjesëmarrës ne procedurat e prokurimeve”.</p> <p><i>2. Në kuadrin ligjor të fushës së Prokurimeve Publike, të parashikohen procedurat që mbulojnë raste kur Autoriteteve Kontraktuese u lind përgjegjësia për të njoftuar Autoritetin e Konkurrencës, në rastet kur gjatë projektimit dhe/ose zhvillimit të procedurave të prokurimit vihen</i></p>	<p>Është rënë dakort me institucionet pëkatëse dhe aktet janë në proces rishikmi</p>

		<p>re shenja të marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike. Në bashkëpunim me Autoritetin e Konkurrencës të formulohet një kre i veçantë në VKM nr. 1 “Për rregullat e prokurimit publik” (ose në çfarëdo lloj akti tjetër ligjor që konsiderohet i përshtatshëm) në të cilin të përcaktohen rastet e mësipërme.</p> <p>II. Ti rekomandojë Agjencisë së Prokurimit Publik:</p> <p>3. Përfshirjen në dokumentet standarte të tenderit të çertifikatës për oferte te pavarur.</p> <p>4. Hartimi i një Udhëzuesi të përbashkët për luftimin e marrëveshjeve në oferta në prokurimet publike.</p> <p>5. Hartimi i Guidës “Mbi zbulimin e marrëveshjeve në oferta në prokurimet publike dhe për të reduktuar marrëveshjet në oferta në prokurimet publike”, si dhe Flet-Palosjes “Për sinjalet e një marrëveshje të ndaluar në oferta në prokurimet publike”.</p> <p>6. Bashkëpunimin për trajnimin e zyrtarëve të prokurimit mbi rëndësinë e zbulimit dhe parandalimit të marrëveshjeve në oferta, mënyrat dhe mjetet e luftimit të këtyre marrëveshjeve me pasoja mjaft të rënda për konkurrencën, taksapaguesit dhe vetë buxhetin e shtetit.</p>	
<u>5</u>	<p>Vendimi i K. të Konkurrencës Nr. 159, dt. 19.11. 2010 “Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e ener.elektrike.”</p>	<p>Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit Nr. 159, datë 19.11. 2010 “Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e energjisë Elektrike”, Vendosi:</p> <p>1. <i>T’i rekomandojë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Entit Rregullator të Energjisë Elektrike:</i></p> <p>1.1 <i>Ndarjen funksionale dhe financiare reale të “Furnizuesit Publik me Shumicë” nga KESH-Gen, e cila do të krijojë kushtet për konkurrencë në këtë nivel tregu për të gjithë të interesuarit (PPE, PVE, Furnizuesit e Kualifikuar) për të kryer transaksione konkurruese dhe është në zbatim të modelit të tregut.</i></p> <p>1.2 <i>Ndarjen financiare reale të “Operatorit i Sistemit të Shpërndarjes” dhe “Furnizuesit Publik me Pakicë”, në mënyrë që të operojnë si njësi të ndara financiarisht, pasi këto segmente tregu janë të liberalizuara dhe është një instrument që ndikon në rritjen e konkurrencës në këtë segment të tregut.</i></p> <p>1.3 <i>Përshpejtimin e procesit të rishikimit të Kontratës me Klientët tariforë duke përcaktuar detyrimet e Furnizuesit Publik me Pakicë</i></p>	<p>Nuk jemi njoftuar mbi marrjen në konsiderat, ose jo, te tyre.</p>

		<i>për mbrojtjen e konsumatorit nëpërmjet respektimit të treguesve të cilësisë së shërbimit (furnizimi vs mungesës së energjisë dhe saktësisë së faturimit).</i>	
6	Vendimi i Komisionit të Konkurrencës Nr. 161 , datë 02.12.2010 "Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në sektorin e komunikimeve elektronike në tregun e teknologjisë me bazë të gjerë" 3G".	Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit Nr. 161 , datë 02.12.2010 "Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në sektorin e komunikimeve elektronike në tregun e teknologjisë me bazë të gjerë" 3G", Vendosi: 1. T'i rekomandojë Ministrisë së Inovacionit dhe Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit liberalizimin e tregut të shërbimit të 3G, duke dhënë licencat e tjera për këtë shërbim, sa më parë që të jetë e mundur. Këto licenca të jepen në të njëjtën kohë në mënyrë që të rritet konkurrenca e lirë dhe efektive në këtë treg për shërbimin "3G". Kushtet e dhënies së këtyre licencave duhet të jenë të njëjta me ato të përcaktuara në licencën e parë të akorduar. 2. T'i rekomandojë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare rregullimin e tregut të shërbimit të teknologjisë me brez të gjerë mbi baza të metodologjive transparente dhe të rregullojë tarifën e shërbimit të orientuar drejt kostos.	Nuk jemi njoftuar mbi marrjen në konsideratë, ose jo, të tyre.

Shtojcë 4: Raport progresi i Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2010 (Konkurrenca)

Kapitulli 8: Konkurrenca

Acquis për konkurrencën përfshin anti-trust, përqendrimet si dhe kontrollin e politikave të ndihmës shtetërore. Ajo përfshin rregullat dhe procedurat për luftimin e sjelljeve anti konkurrese nga ndërmarrjet (marrëveshjet kufizuese ndërmjet ndërmarrjeve dhe abuzimi me pozitën dominuese), të shqyrtojë përqendrimet dhe të parandalojë qeverinë në dhënien e granteve të ndihmës shtetërore të cilat shtrembërojnë konkurrencën në tregun e brendshëm.

Rregullat e konkurrencës janë direkt të zbatueshme brenda Bashkimit Evropian dhe shtetet anëtare duhet të bashkëpunojnë plotësisht me Komisionin për zbatimin e tyre. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) përfshin dispozita që lidhen ngushtë me një pjesë të gjerë të acquis në fushën e konkurrencës. Këto përfshijnë marrëveshjet anti konkurrese ndërmjet ndërmarrjeve, abuzimin me pozitën dominuese dhe ndihmën shtetërore që shtrembëron konkurrencën. MSA-ja përfshin rregulla që zbatohen për ndërmarrjet publike dhe për ndërmarrjet të cilave iu janë dhënë të drejta të veçanta dhe ekskluzive dhe ndalon kufizimet sasiore mbi importet nga BE-ja në Shqipëri. MSA-ja parashikon për autoritetet publike aktive të pavarura mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave të konkurrencës. Gjithashtu ajo përfshin një protokoll ku janë të parashikuara rregullat për ndihmën shtetërore për sa i përket sektorit të hekurit dhe çelikut.

Për sa i përket anti trustit dhe përqendrimeve, Ligji aktual i konkurrencës zbatohet për të gjithë sektorët e ekonomisë dhe është modeluar sipas rregullave të BE-së. Ligji është amenduar në Shtator të 2010 dhe tashmë është në linjë me elementët thelbësorë të acquis. Ligji i amenduar në mënyrë domethënëse ul vlerat e kufijve të xhiros për njoftimet e përqendrimeve pranë Autoritetit Shqiptar të Konkurrencës. Kjo mund të çojë në një rritje të njoftimeve duke e bërë të rëndësishme faktin nëse ka AK kapacitetet administrative të mjaftueshëm për tu marrë me këtë rritje të rasteve. Për sa i përket kapaciteteve administrative, AK është një organ publik dhe një entitet i pavarur ligjor i cili ushtron detyrat e tij në mënyrë të pavarur dhe raporton në parlament. Kryetari dhe 4 anëtarët e organit vendim marrës-Komisioni i Konkurrencës-janë zgjedhur nga Parlamenti për një periudhë 5 vjeçare. AK ka fuqi hetimore të mjaftueshme që përfshijnë kërkimin e informacionit dhe kontrollin në ambientet e ndërmarrjeve. Gjithashtu mund të vendosë gjopa mbi ndërmarrjet dhe organet publike. Kufijtë e gjobave janë rishikuar për ti sjellë afër në linjë me politikën e BE-së. Vendimet e AK-së janë objekt rishikimi gjyqësor. AK mundet gjithashtu të ndërhyjë në sektorët e rregulluar duke dhënë rekomandime. Stafi i AK-së prej 35 personash duket i pamjaftueshëm, duke pasur në konsideratë detyrat e shumta që i jepen autoritetit dhe uljen e kufirit të njoftimeve të përqendrimeve.

Për sa i përket liberalizimit, Ligji i Konkurrencës përfshin edhe parimet e acquis për sa i përket shërbimeve të interes të përgjithshëm ekonomik. Një numër ndërmarrjesh në transport, shërbime publike, shërbime postare dhe sektorin

energjetik kanë të drejta të veçanta dhe ekskluzive. Disa sektorë të caktuar mbikëqyren nga autoritete rregullatorë sektoriale. Analizë e mëtejshme mbi përputhshmërinë e këtyre praktikave me acquis nevojitet të kryhet.

Konkluzion: Kuadri ligjor shqiptar në fushën e konkurrencës është gjerësisht i bazuar në rregullat e BE-së dhe strukturat e nevojshme dhe administrative janë krijuar. Megjithatë, kujdes duhet treguar për të garantuar pavarësinë operationale dhe të kapaciteteve administrative të Autoritetit të Konkurrencës dhe ndihmës shtetërore në mënyrë që ato të mund të zbatojnë ligjin në mënyrë eficiente. Pavarësia aktuale e sektorëve të rregulluar duhet të tregohet. Kërkohet monitorim i mëtejshëm dhe analizë drejt progresit të Shqipërisë për liberalizimin e tregut në sektorë të caktuar në linjë me acquis .

Në përgjithësi, Shqipëria duhet të ndër marrë përpjekje të mëtejshme për tu përshtatur me acquis dhe të implementojë në mënyrë efektive ato në termat afatmesme.

Shtojce 5: Struktura e Autoritetit të Konkurrencës

